



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Fakulteti i Edukimit**

**DORACAK PËR MËSIMIN PRAKTIK
Për studentët e programeve Master në Fakultetin e
Edukimit**

Mars, 2017

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”



DORACAK PËR MËSIMIN PRAKTIK

Për studentët e programeve Master në Fakultetin
e Edukimit

Fakulteti i Edukimit
Mars, 2017

Med@UP



Hartuar me ndihmën e projektit TEMPUS “Modernizimi i shkollimit të mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës”, (Nr. 544023/2013), financuar nga Bashkimi Evropian.

PËRMBAJTJA

<u>HYRJE</u>	1
<u>MËSIMI PRAKTIK</u>	2
<u>Parimet udhëzuese/ Bashkëpunimi</u>	3
<u>Figura 1. Parimet udhëzuese/ Bashkëpunimi</u>	3
<u>I. ORGANIZIMI I MËSIMIT PRAKTIK</u>	5
<u>Mësimi praktik në fakultet</u>	5
<u>Mësimi praktik në shkollë</u>	5
<u>II. POLITIKAT DHE PROCEDURAT E PËRGJITHSHME</u>	7
<u>Përgjegjësitë dhe detyrat ndaj nxënësve</u>	7
<u>Mungesa e mësimdhënësit mentor</u>	9
<u>Mungesa e studentit mësimdhënës</u>	9
<u>Veshja dhe dukja e studentëve mësimdhënës</u>	10
<u>Përdorimi i materialeve të shkollës nga studentët mësimdhënës</u>	10
<u>Planifikimi i studentit mësimdhënës</u>	10
<u>Dokumentimi i mësimdhënies së studentit</u>	10
<u>III. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE GJATË MËSIMIT PRAKTIK</u>	11
<u>VI. KODI I MIRËSJELLJES PROFESIONALE PËR STUDENTËT MËSIMDHËNËS</u>	13
<u>Në lidhje me nxënësit</u>	13
<u>Në lidhje me autoritetet e shkollës</u>	13
<u>Në lidhje me studentët tjerë mësimdhënës</u>	13
<u>Në lidhje me Fakultetin e Edukimit</u>	13
<u>Në lidhje me profesionin</u>	14
<u>V. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE</u>	15
<u>Programi i Praktikës pedagogjike I, II dhe III</u>	15
<u>VI. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE I</u>	21
<u>Njoftimi me shkollën dhe mësimdhënësin mentor</u>	21
<u>Zhvillimi i njohurive për mësimdhënien</u>	21
<u>Vëzhgimi i ambientit fizik dhe shoqëror</u>	21
<u>Shembull i shkrimit në ditar nga studentit mësimdhënës</u>	22
<u>Vëzhgimi i organizimit për nxënie</u>	22
<u>Fokusi: Vëzhgimi i komunikimit në klasë</u>	24
<u>Detyrat gjatë vëzhgimit të komunikimit në klasë</u>	24
<u>Fokusimi në menaxhimin e klasës/sjelljen e nxënësve</u>	25
<u>Detyrat e vëzhgimit të menaxhimit në klasë</u>	25
<u>Vëzhgimi i sjelljeve të nxënësve</u>	26
<u>Fokusimi në vetveten si mësimdhënës</u>	27
<u>Detyrat e vëzhgimit të vetvetes si mësimdhënës</u>	28
<u>VII. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE II</u>	30

<u>VIII. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE III</u>	31
<u>IX. REFLEKTIMI DHE TË SHKRUARIT REFLEKTIV NË DITAR</u>	32
<u>Cka është reflektimi?</u>	32
<u>Pse është i rëndësishëm reflektimi për përgatitjen e mësimitdhënësve?</u>	32
<u>Si mund të angazhohen studentët mësimitdhënës në reflektim?</u>	33
<u>Udhëzime për diskutim reflektiv</u>	33
<u>Një porosi për studentët mësimitdhënës</u>	34
<u>Udhëzime të përgjithshme për të shkruarit reflektiv</u>	35
<u>Të shkruarit reflektiv në ditar</u>	36
<u>Fillimi i të shkruarit reflektiv të ditarit</u>	37
<u>Për çfarë temash duhet të shkruajnë studentët mësimitdhënës?</u>	39
<u>Informatat kthyesë për ditarët</u>	39
<u>Udhëzime për ditarët e studentëve mësimitdhënës</u>	40
<u>X. MBIKËQYRJA E STUDENTËVE MËSIMDHËNËS</u>	42
<u>Mbikëqyrja</u>	42
<u>Cikli mbikëqyrës</u>	43
<u>Raporti profesional</u>	44
<u>Biseda para vëzhgimit</u>	45
<u>Vëzhgimi</u>	46
<u>Analiza</u>	47
<u>Biseda pas vëzhgimit</u>	47
<u>Shënimet dhe reflektimet</u>	47
<u>Udhëzime për mbikëqyrje</u>	48
<u>Përmbledhje e procesit të mbikëqyrjes</u>	48
<u>Mbledhja e të dhënave</u>	48
<u>Teknikat e vëzhgimit</u>	49
<u>Udhëzime për vëzhgimin e studentëve mësimitdhënës gjatë Mësimit praktik</u>	52
<u>Udhëzime të përgjithshme</u>	52
<u>Informata të rëndësishme për mbikëqyrësit e studentëve mësimitdhënës</u>	53
<u>XI. VLERËSIMI I STUDENTËVE MËSIMDHËNËS</u>	54
<u>Parimet mbi të cilat bazohet matja dhe vlerësimi</u>	56
<u>Procedurat dhe kërkesat në lidhje me matjen dhe vlerësimin</u>	56
<u>Bisedimet me studentët mësimitdhënës</u>	57
<u>Informata kthyesë përkrahëse dhe korrigjuese</u>	58
<u>Vizitat e stafit akademik në shkollë</u>	59
<u>Procedurat e vlerësimit për Praktikën pedagogjike I</u>	60
<u>Rregullore për vlerësimin e Mësimit praktik të studentëve</u>	61
<u>Vlerësimi i Mësimit praktik për studentët</u>	62
<u>Çfarë ndodh nëse studenti nuk i plotëson kriteret e parapara?</u>	62
<u>Vlerësimi i studentëve mësimitdhënës</u>	62
<u>Vlerësimi formativ (gjatë Mësimit praktik)</u>	63
<u>Vlerësimi përmbyllës (final)</u>	63
<u>Procedurat e vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III</u>	64
<u>SHTOJCA</u>	65

HYRJE

Komponenti i Mësimi praktik, si pjesë e programit për përgatitjen e mësimitdhënësve, do t'u ofrojë studentëve mundësi të vëzhgojnë modele të mësimitdhënies, të angazhohen në mësimitdhënie, të pranojnë udhëzime konstruktive, të mësojnë për mësimitdhënien dhe për veten e tyre si mësimitdhënës dhe si vetë-vlerësues reflektivë. Hulumtimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e suksesshme të mësimitdhënësve, kanë dëshmuar se përvojat e Mësimi praktik të organizuara, të udhëzuara dhe të mbikëqyrura kanë rëndësi jetike për zhvillimin e mësimitdhënësve të suksesshëm. Hulumtimet, gjithashtu tregojnë se zhvillimi i mësimitdhënësve është një proces i përjetshëm. Mësimitdhënia praktike është një hap i rëndësishëm fillestar në këtë proces të gjatë.

Qëllimi i Mësimi praktik është që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimitdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe shkollës së mesme të lartë. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies, për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas plan-programit të shkollës.

Programi i Mësimi praktik dizajnohet në atë mënyrë që të jetë zhvillimor. Kjo do të thotë se aftësimi profesional i studentëve mund të bëhet gradualisht, duke bërë detyra më komplekse në klasë. Studentët fillojnë duke vrotuar dhe ndihmuar të tjerët dhe pastaj gradualisht marrin përgjegjësitë për mbajtjen e orës së parë mësimore, dhe më vonë, duke ligjëruar njësi më të mëdha mësimore. Në këtë mënyrë, studentët fillojnë duke i ndihmuar mësimitdhënësit e tyre mentorë rreth detyrave që nuk kanë të bëjnë me mësimitdhënien drejtpërdrejtë dhe rreth rregullave shkollore, para se gradualisht të marrin përgjegjësi të plotë për të gjithë detyrat e mësimitdhënësit në klasë. Natyra zhvillimore e programit, gjithashtu, merr parasysh faktin se ka shumë dallime në mes të pritjeve të studentëve dhe praktikës në shkolla. Brenda të priturve të gjera për secilin semestër, programi i lejon studentët që t'i marrin përgjegjësitë në një hap me të cilin ata mund të jenë të suksesshëm.

Si përmbledhje, Mësimi praktik është një rast i mirë për studentët që t'i integrojnë njohuritë e tyre teorike mbi zhvillimin dhe të nxënies e nxënësve me zhvillimin e shkathtësive praktike të mësimitdhënies, në një ambient që përkrah të nxënies dhe zhvillimin profesional të tyre. Mësimi praktik konsiderohet nga të gjithë profesionistët si pika më e rëndësishme e trajnimit të mësimitdhënësve.

Qëllimi i këtij doracaku është që të komunikojë parimet që e drejtojnë zhvillimin e programit, si dhe të përshkruajë të priturat, kërkesat, rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me implementimin e Mësimi praktik.

MËSIMI PRAKTIK

Hulumtimet mbi programet e suksesshme për përgatitjen e mësimitdhënësve vazhdimisht kanë dëshmuar që përvojat në Mësimin praktik, të organizuara, të udhëzuara dhe të mbikëqyrura, janë qenësore për zhvillimin e mësimitdhënësve të suksesshëm.

Fakulteti i Edukimit është i njohur për zhvillimin e praktikës profesionale, e cila është edhe njëra nga karakteristikat themelore, që e veçon këtë fakultet nga fakultetet e tjera.

Programet Master për profilin lëndor, shërbejnë në kontekst të përgjithshëm për të plotësuar profilin e mësimitdhënësit që do të vijë nga departamentet akademike të fakulteteve dhe universiteteve tjera. Plotësimi i profilit bëhet me njohuritë pedagogjike, didaktike si dhe praktike. Ky program në mënyrë më të veçantë i kontribuon qasjes dhe tendencës së MASHT, që përmes politikave të ndryshme në këtë fushë, synon avancimin e perceptimit të profesionalizimit të mësimitdhënësit në sistemin arsimor, si dhe i kontribuon edhe ngritjes së statusit të mësimitdhënësit në shoqëri në përgjithësi.

Qëllimi i përgjithshëm i programeve Master në mësimitdhënie lëndore është që të avancohen më tutje kompetencat moderne të mësimitdhënies dhe të Praktikës pedagogjike krahas atyre akademike, duke marrë për bazë edukimin paraprak dhe nevojat e secilit profil të mësimitdhënies lëndore.

Fakulteti i Edukimit ofron këto programet të nivelit Master (Tabela 1) për mësimitdhënie lëndore – specializimi përkatës në:

Tabela 1. Programet të nivelit Master

Mësimitdhënien e Gjuhës dhe letërsisë shqipe
Mësimitdhënien e Matematikës
Mësimitdhënien e Fizikës
Mësimitdhënien e Biologjisë
Mësimitdhënien e Kimisë
Mësimitdhënien e Historisë
Mësimitdhënien e Gjeografisë
Mësimitdhënien e Teknologji dhe TIK

Duke zhvilluar një partneritet cilësor me institucionet arsimore- shkollore, studentët në Fakultetin e Edukimit janë të lidhur me Praktikën – Mësimin praktik, i cili implementohet gjatë studimit.

Praktika mësimore organizohet gjatë vitit të parë të studimeve (semestri i dytë) dhe vitit të dytë në të dy semestrat. Me anë të Mësimin praktik, studentët lidhin dhe pasurojnë njohuritë që ata fitojnë në fakultet, me përvojën praktike nën udhëheqjen e mësimdhënësve mentorë dhe profesorëve të Praktikës pedagogjike.

Parimet udhëzuese/ Bashkëpunimi




Figura 1. Parimet udhëzuese/ Bashkëpunimi

Baza e një Mësimi praktik të suksesshëm për një student, qëndron në supet e mësuesit mentor, studentit dhe mbikëqyrësit të fakultetit, të cilët bashkëpunojnë dhe fokusohen në të nxënit e studentit. Parimet udhëzuese rreth këtij bashkëpunimi janë si më poshtë:

- Fakulteti i Edukimit do të sigurojë përvoja të praktikës së mësimdhënies të cilësisë së lartë, në të cilat të gjithë studentët do të kenë rastin që në mënyrën më të mirë ta zhvillojnë potencialin e tyre për t'u bërë mësimdhënës efektivë dhe të suksesshëm.
- Praktika e studentëve do të konsiderohet si pjesë integrale e programit, që nuk do të modifikohet dukshëm me rastin e ndryshimit të programit.
- Të gjithë studentët do të marrin pjesë plotësisht në komponentin e praktikës së studentëve të programit, si parakusht për përmbushjen e kërkesave për diplomim.
- Programi i praktikës së studentëve do të përfshijë edhe kohën e kaluar në shkollë - duke vëzhguar dhe duke mësuar nxënësit, edhe kohën e kaluar në fakultet - duke u përgatitur dhe duke reflektuar mbi mësimdhënien, të cilën e kanë mbajtur me nxënës.

- Gjatë dy viteve studentët do të zhvillojnë Mësimin praktik në të dy nivelet (shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë).
- Studentët do të përgatiten për të realizuar kurrikulin e shkollave të mesme të ulëta dhe të larta në Kosovë dhe për t'i angazhuar nxënësit në aktivitete të nxënies, të cilat janë në rrjedha me hulumtimet aktuale përkitazi me atë se si mësojnë nxënësit.
- Gjatë Mësimin praktik, për secilin student do të caktohet nga një mësimdhënës mentor, gjithherë kur kjo është e realizueshme, për të siguruar nxënie të cilësisë së lartë dhe mbikëqyrje efikase.
- Shkollat, mësimdhënësit mentorë dhe Fakulteti i Edukimit do të konsiderohen partnerë në përgatitjen e mësimdhënësve.
- Mësimdhënësit mentorë do ta kenë përkrahjen që u duhet për t'u ofruar studentëve përvoja të kualitetit të lartë të Mësimin praktik.
- Studentët do të ndihmohen në praktikën e tyre, në mënyrë që të arrijnë suksese.

I. ORGANIZIMI I MËSIMIT PRAKTIK

Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë njëri me tjetrin:

- Mësimin praktik në fakultet dhe
- Mësimin praktik në shkolla.

Mësimi praktik në fakultet

Mësimi praktik në Fakultet organizohet në ambientet e fakultetit dhe është pjesë përbërëse e Mësimin praktik si tërësi dhe ka dy qëllime kryesore:

T'u ofrojë studentëve *përgatitjen* që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa.

T'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për *reflektim dhe diskutim*, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë.

Gjatë këtyre orëve studentët:

- do të analizojnë dhe kuptojnë rolin dhe organizimin e shkollës,
- do të identifikojnë rolet e ndryshme të mësuesit,
- do të marrin informata lidhur me mësimdhënien,
- do të bëjnë planifikimin efektiv të mësimin,
- do të studiojnë dhe do të eksperimentojnë me strategjitë për vëzhgim në klasa,
- do të identifikojnë dhe praktikojnë teknika të mësimdhënies,
- do të vlerësojnë të nxënit për të përcaktuar deri në çfarë mase janë arritur objektivat mësimore,
- do të diskutojnë për atë që e kanë vrojtuar dhe nxënë në shkollë,
- do të mësojnë për reflektimin (të menduarit me kujdes) si një strategji për të mësuar nga përvoja,
- do të angazhohen në reflektimin dhe vetëvlerësimin e aftësimin profesional.

Pasi që studentët punojnë së bashku para dhe pasi të shkojnë në shkolla, ata do të inkurajohen që të formojnë një rrjet kolegial. Ata do të udhëzohen për të parë se si mund ta përkrahin njëri - tjetrin dhe të mësojnë nga njëri – tjetri, si edhe nga profesorët universitarë dhe mësimdhënësit mentorë. Gjatë kësaj kohe, studentët jo vetëm që do t'i zhvillojnë aftësitë dhe qëndrimet që nevojiten për t'i mësuar të tjerët, por gjithashtu, do t'i zhvillojnë shkathtësitë e vrojtimit dhe të vlerësimit, që u duhen atyre për t'u bërë mësimdhënës reflektivë, në mënyrë që të jenë në gjendje të monitorojnë aftësimin dhe zhvillimin e tyre.

Mësimi praktik në shkolla

Mësimi praktik në shkolla është ngushtë i lidhur me Mësimin praktik në fakultet. Studentët integrojnë përvojat nga vëzhgimet dhe puna praktike me reflektimet dhe diskutimet në klasë dhe

krijonjë qëndrimet dhe besimet personale në lidhje me teorinë e të nxënës, e po ashtu mbi qasjet dhe metodologjinë pedagogjike.

Mësimi praktik në shkollë ka rëndësi të veçantë në përgatitjen e studentëve për punë të pavarur dhe për reflektim kritik. Në këtë proces mësuesit mentorë, luajnë një rol të pazëvendësueshëm. Ata, u mundësojnë studentëve të shohin, përjetojnë dhe provojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre dhe në këtë mënyrë të zhvillojnë edhe kompetencat e tyre të mësimdhënësit. Për këtë arsye, Mësimi praktik në shkollë, asnjëherë nuk mund të zëvendësohet me një aktivitet tjetër ose me Mësim praktik në fakultet.

Mësimi praktik në shkollë, realizohet sipas disa politikave dhe procedurave të përgjithshme të cilat sigurojnë mbarëvajtjen dhe suksesin e synuar. Janë përcaktuar, rolet dhe përgjegjësitë e studentëve, mësimeve mentorë si dhe mësimeve udhëheqës nga fakulteti. Mësimi praktik në shkollë fillon në semestrin e dytë dhe organizohet për dy javë rresht pas përgatitjes paraprake në fakultet (javën e shtatë dhe tetë). Në semestrin e tretë Mësimi praktik në shkollë organizohet për katër javë rresht (javën e 7,8,9,10). Në semestrin e katërt, Mësimi praktik në shkollë organizohet për gjashtë javë rresht (javët 5,6,7,8,9,10) .

II. POLITIKAT DHE PROCEDURAT E PËRGJITHSHME

Përgjegjësitë dhe detyrat ndaj nxënësve

Mësimdhënësit mentorë janë përgjegjës për të nxënit, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve gjatë tërë kohës. Kur mësimdhënia dhe mbikëqyrja e nxënësve transferohet te studenti mësimdhënës, mësimdhënësi mentor duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar të nxënit dhe sigurinë e nxënësve. Studenti mësimdhënës nuk duhet të lihet vetëm në klasë deri në kohën kur mësimdhënësi mentor dhe mbikëqyrësit e fakultetit besojnë se studenti është në gjendje ta mbajë këtë përgjegjësi vetëm.

Rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve mentorë

Mësimdhënësit mentorë janë model për studentët për sa i përket të gjithë aspekteve të mësimdhënies. Ndikimi i tyre në zhvillimin personal dhe profesional është i rëndësishëm, mjaft i gjerë dhe i vazhdueshëm. Për këtë arsye, përgjegjësitë e mësimdhënësit mentor, asnjëherë nuk mund të përmbliidhen në një listë të vetme, sepse nga rasti në rast mund të ndryshojnë apo të shtohen.

Më poshtë janë paraqitur disa prej këtyre përgjegjësive:

1. Mësimdhënësit mentorë duhet të njihen me programin për përgatitjen e mësimdhënësve në Fakultetin e Edukimit të Universitetin e Prishtinës dhe të kuptojnë se çfarë pritet nga programi.
2. Mësimdhënësit mentorë do të ushtrojnë sjellje profesionale, të cilat do të bëhen shembull për të gjitha aspektet e të qenit mësimdhënës.
3. Mësimdhënësit mentorë do të përpiqen që studentët të ndihen të mirëseardhur në klasë dhe në shkollë. Kjo do të përfshijë disa veprime, si:
 - a) përgatitjen paraprake të nxënësve, duke i informuar për ardhjen e studentëve mësimdhënës;
 - b) ofrimin e hapësirës për studentin mësimdhënës në klasë, duke ofruar një karrige dhe një tavolinë ku ai/ajo mund të punojë;
 - c) prezantimin e studentëve mësimdhënës para nxënësve dhe prindërve në ndonjë mbledhje të radhës;
 - d) prezantimin/njohjen e studentëve mësimdhënës me mësimdhënës të tjerë dhe stafin tjetër të shkollës;
 - e) të bëhen biseda me studentin mësimdhënës në lidhje me pritshmëritë që ka studenti për Praktikën pedagogjike, për bindjet dhe qasjen e studentit ndaj profesionit të mësimdhënësit dhe të të nxënit;
 - f) të jepen ndihmesa për studentin mësimdhënës, që t'i njohë sa më parë nxënësit, duke i përfshirë ata në aktivitete sipas planit të Praktikës pedagogjike;
 - g) të bëhet sqarimi i orarit e i rutinave ditore të nxënësve, në mënyrë që studenti të kuptojë çfarë pritet prej nxënësve në secilën kohë;

h) të kihet respekt për idetë dhe vendimet e studentit.

4. Mësimdhënësit mentorë do të kalojnë një pjesë të kohës, çdo ditë, me studentët mësimdhënës për t'u ofruar atyre udhëzime dhe ndihmë.

a) Mësimdhënësit mentorë do të diskutojnë paraprakisht planifikimin e orës mësimore të përgatitur nga studenti, sipas nevojës do të japin sugjerime për këtë planifikim dhe pas mbajtjes së orës mësimore do të diskutohet rreth implementimit të atij planifikimi.

b) Mësimdhënësit mentorë do të planifikojnë së bashku me studentin rreth tërë ditës mësimore, do të ndajnë përgjegjësitë, varësisht prej nivelit që ka arritur studenti. Në kohën kur studenti mban mësimin i pavarur, do të duhet që ai të bëjë më tepër edhe rreth planifikimit të mësimin. Kjo do të kërkojë që studenti dhe mësimdhënësi mentor të kalojnë një kohë bashkë, për të organizuar se çfarë do të ligjërojë studenti dhe çfarë do të ligjërojë mësimdhënësi mentor.

c) Për secilën njësi mësimore që studenti do ta udhëheqë, të ndihmohet për të vendosur se çka ai apo ajo do të ligjërojë dhe të sugjerohen strategjitë që mendohet se janë zbatuar më me sukses, si dhe ato që ai i ka mësuar në orët e metodikës.

d) Pasi studenti ta ketë planifikuar njësinë mësimore, të kërkohet nga ai/ajo që të shpjegojë planin para se të mbahet ora mësimore. Nëse plani nuk ka qenë i suksesshëm, studenti të ndihmohet të bëjë ndryshime. Rekomandohet që planet e njësive mësimore të rishikohen së paku një ditë përpara, për të lejuar mundësi për ndryshime eventuale.

e) Pasi studenti të ketë zhvilluar njësinë mësimore (apo të ketë udhëhequr një aktivitet), të diskutohet me të se si shkoi ora. Të fillohet duke e pyetur studentin se çfarë mendon ai/ajo për orën e mbajtur. Të përshkruhet ajo që studenti e ka bërë mirë dhe të japin sugjerime për atë që mund të përmirësohet. Të inkurajohet studenti që të bëjë vetëvlerësimin e punës së tij dhe të caktojë qëllimet për përmirësim.

5) Mësimdhënësi mentor duhet t'i ndajnë mjetet që janë në dispozicion me studentët mësimdhënës. Dihet që në disa shkolla mjetet janë të kufizuara.

Mësimdhënësit mentorë dhe studentët duhet të punojnë së bashku për të shfrytëzuar më së miri mjetet dhe materialet që janë në dispozicion.

6) Të vrojtohen studentët me kujdes dhe të diskutohet puna e tyre me ta. Çdo herë, pasi të jetë vrojtuar studenti duke mbajtur mësim, të shënohen vrojtimit në ditarin e mbikëqyrësit. Shënime në ditar duhet të përfshijnë edhe vrojtimit derisa studenti ka mbajtur mësim edhe përmbledhjen e diskutimit, si dhe fushat e identifikuar në të cilat studenti duhet të përmirësohet.

7) Numri i vizitave zyrtare (formale) të jetë në përputhje me rekomandimet e fakultetit. Kjo do të ndryshojë sipas nivelit të orëve. Numri i vizitave gjatë të cilave studenti vrojtohet zyrtarisht (biseda para vrojtimit, biseda pas vrojtimit) do të varet nga niveli i Mësimin praktik. Në përgjithësi, pas nivelit të parë, pritet që studentët të vizitohen zyrtarisht për një orë mësimore secilën ditë, edhe nëse ata mund të mbajnë më shumë se një orë mësimore.

9) Mësimdhënësit mentorë do t'i shënojnë vrojtimit e tyre, si edhe rekomandimet e tyre në ditarin e mbikëqyrësit dhe do t'i plotësojnë këta ditarë vazhdimisht. Shënime në ditar nuk duhet të jenë të gjata. Ato duhet të paraqesin një regjistër të asaj se çfarë ka ligjëruar studenti, çfarë ka bërë mirë dhe cilat fusha janë të identifikuar për përmirësime dhe shënime lidhur me progresin e bërë.

10) Mësimdhënësit mentorë duhet t'i inkurajojnë studentët mësimdhënës që të reflektojnë (të mendojnë me kujdes dhe në mënyra kritike) për punën e tyre dhe të mësojnë nga përvoja e tyre.

11) Mësimdhënësit mentorë do të asistojnë te studentët mësimdhënës për të përcaktuar vrojtimin në klasat tjera, për të zgjeruar përvojat e tyre. Qëllimi tjetër i vizitës në klasë është që t'u jepet studentëve mundësia për të parë zhvillimin dhe nxënien e vazhdueshme të nxënësve nga një klasë në tjetrën, si dhe të zgjerojnë mundësinë e tyre për të vrojtuar mësimdhënësit në punën e tyre.

12) Mësimdhënësit mentorë duhet të bashkëpunojnë me Fakultetin e Edukimit në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me studentët mësimdhënës, duke përfshirë vlerësimin e punës së studentëve mësimdhënës.

13) Mësimdhënësit mentorë duhet të kontaktojnë me anëtarin mbikëqyrës të fakultetit kur ngrihen çështje ose brenga.

14) Mësimdhënësit mentorë duhet të sigurojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga fakulteti, sipas mënyrës dhe formës se si është ky dokumentacion.

15) Mësimdhënësit mentorë duhet të marrin pjesë në të gjitha seancat e trajnimit që ofrohen për mësimdhënësit mentorë sipas kërkesës. Disa trajnime do të ofrohen nga mësimdhënësit apo bashkëpunëtorët e fakultetit, nga mësimdhënësit mentorë dhe disa nga këshilltarët.

Mungesa e mësimdhënësit mentor

Nëse ndodh që mësimdhënësi mentor të mungojë patjetër në shkollë, kur ai/ajo ka përgjegjësi për një student mësimdhënës, duhet që paraprakisht të bëhen aranzhimet e duhura për mbikëqyrjen e studentit mësimdhënës. Studenti mësimdhënës mund të punojë me një mësimdhënës tjetër mentor gjatë kohës së asaj mungese, në qoftë se ajo kohë është e shkurtër, ose të punojë me një mësimdhënës zëvendës. Në asnjë kohë, studentit mësimdhënës nuk duhet të lejohet që të marrë përgjegjësi të plotë për klasën.

Mungesa e studentit mësimdhënës

- Studentët duhet të ndjekin Mësimin praktik në të gjitha ditët edhe në fakultet edhe në shkollë.
- Sëmundja dhe emergjenca familjare janë arsytet e vetme për mungesën e studentit nga Mësimi praktik.
- Nëse studentit i duhet të mungojë, ai duhet ta lajmërojë profesorin para orës dhe të kujdeset që ai ta marrë informatën dhe materialet që ofrohen në orë.
- Nëse studentit i duhet të mungojë nga shkolla, studentit duhet ta lajmërojë mësimdhënësin mentor dhe mbikëqyrësit e fakultetit sa më shpejt që të jetë e mundur. Nëse studentit ka përgjegjësi të mësimdhënies për atë ditë, studentit duhet t'i bëjë të gjitha tentimet e arsyeshme për të pajisur mësimdhënësin mentor me planin për mësimdhënie. Për shembull, planet mund të dërgohen në shkollë nga ndonjë student tjetër mësimdhënës.
- Duke parashikuar numrin e ditëve të mungesës nga shkolla, studentit mund t'i kërkohet t'i plotësojë këto ditë në një kohë tjetër. Kur një student mungon më shumë se një ditë, është

përgjegjësi e studentit që të konsultojë mësuesin mentor dhe mbikëqyrësin e fakultetit në lidhje me kërkesat për t'i plotësuar ato ditë. Mungesa e vazhdueshme mund të rezultojë në dështim të Mësimit praktik.

Veshja dhe dukja e studentëve mësues

Studentët priten ta prezantojnë veten e tyre si profesionistë. Studentët duhet të respektojnë kodin e veshjes së shkollës ku ata janë caktuar dhe në të gjitha rastet të jenë të veshur mirë dhe pastër.

Përdorimi i materialeve të shkollës nga studentët mësues

Studentët ftohen të përdorin të gjitha pajisjet dhe materialet që janë në dispozicion në shkollat e tyre në të njëjtën mënyrë që këto përdoren nga mësuesit e tyre mentorë. Studentët duhet të jenë të vetëdijshëm se materialet shpenzuese, siç janë pajisjet e artit, mund të jenë të kufizuara dhe duhet të ndahen midis të gjithë mësuesve. Përdorimi i pajisjeve dhe materialeve të specializuara, siç janë pajisjet e laboratorit, duhet të bëhet në konsultim me mësuesin mentorë.

Planifikimi i studentit mësues

Studentët priten të planifikojnë dhe të përgatitin plane të shkruara në lidhje me të gjitha aktivitetet e mësimit dhe nxënies për të cilat ata marrin përgjegjësi. Masa dhe formati i planeve do të varet nga tema, aktiviteti, niveli i klasës dhe nxënësit me të cilët mbahet mësimi. Për më shumë, mësuesin mentorë dhe mbikëqyrësin e fakultetit mund të bëjnë kërkesa të caktuara. Studentët duhet të kënaqin mësuesin mentorë me faktin se janë të përgatitur mjaft. Nëse studentët mësues nuk janë të përgatitur në mënyrë adekuate, mësuesin mentorë mund të refuzojnë që t'i lejojnë ata të japin mësime.

Dokumentimi i mësimit të studentit

Tërë dokumentacioni që ka të bëjë me punën dhe aftësitë e studentit mësues do të ndahet me studentin mësues. Studentit mësues do t'i jepet një kopje e vlerësimit final, e shkruar nga mësuesin mentor dhe profesori i Praktikës pedagogjike.

III. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE GJATË MËSIMIT PRAKTIK

Në këtë pjesë të doracakut do të sqarohen të gjitha rolet dhe përgjegjësitë e studentëve gjatë Praktikës mësimore në shkollë dhe në fakultet. Në mënyrë që ata të përfitojnë sa më shumë nga koha e përcaktuar për Mësimin praktik:

1. Studentët duhet t'i ndjekin të gjitha orët që kanë të bëjnë me Mësimin praktik dhe duhet të jenë të pranishëm në shkollën në të cilën janë caktuar për të qenë çdo ditë të Mësimit praktik. Sëmundja është e vetmja arsye që mund të pranohet në rast mungese. Nëse janë të sëmurë, studentët duhet të bëjnë çdo gjë që është e mundur për ta lajmëruar profesorin e tyre ose mësimdhënësin mentor, se ata nuk janë në gjendje të ndjekin orën. Është përgjegjësi e studentit që të gjejë informatat lidhur me atë që ka ndodhur në orën kur ai ka munguar.
2. Studentët duhet të përmbushin të gjithë detyrat e caktuara, që kanë të bëjnë me Mësimin praktik. Kjo përfshin edhe kërkesën për shkrimin në ditar.
3. Studentët pritet që të demonstrojnë sjellje profesionale gjatë tërë kohës. Kjo përfshin, por nuk është e kufizuar vetëm në:
 - Zhvillimin e marrëdhënieve pozitive, profesionale me mësimdhënësin mentor dhe me mbikëqyrësin e fakultetit.
 - Tregimin e respektit për personelin e shkollës dhe nxënësve.
 - Tregimin e entuziazmit për nxënie dhe të qenit gati për të nxënë nga të gjitha situatat dhe përvojat.
 - Përdorimin e udhëzimeve dhe këshillave nga mësimdhënësi mentor, si edhe nga profesori i lëndës nga Fakulteti i Edukimit për të përmirësuar punën.
 - Pranimin e dallimeve individuale, të jetë i lirë nga paragjykimet dhe diskriminimi.
 - Respektimin e besueshmërisë së informatës për nxënësit.
 - Të jetë i ndershëm dhe i drejtë në të gjitha bashkëveprimet me stafin dhe nxënësit.
 - Të jetë i saktë, i besueshëm dhe i organizuar.
 - Të jetë i veshur mirë dhe pastër.
4. Kërkohet që studentët të njihen dhe t'i përcjellin praktikat dhe rregullat e klasës.
5. Kërkohet që studentët të njihen dhe të përcjellin orarin e shkollës dhe të klasës, duke përfshirë kohën e fillimit dhe të mbarimit, pushimet si edhe kohën për secilën lëndë.
6. Kërkohet që studentët të vijnë në shkollë 20 minuta para se të fillojë dita ose ndërrimi, të cilin e vijojnë mësuesit mentorë të tyre dhe nxënësit.
7. Kërkohet që studentët të rregullojnë kohën për të biseduar me mësimdhënësin e tyre mentor për çdo ditë. Këtë herë, kjo do të jetë në fund të ditës (apo ndërrimit) dhe do të jetë për afërsisht 30 - 45 minuta, kur ata do të rishikojnë ditën dhe do të planifikojnë aktivitetet të ardhshme dhe përgjegjësi të mësimdhënies.

8. Kërkoheq që studentët të dizajnojnë dhe të zbatojnë udhëzimet e mësimdhënësve të tyre mentorë. **Studentët duhet të përgatisin një plan të shkruar për njësitë mësimore për të cilat ata janë përgjegjës.** Profesorët do t'ua shtrojnë studentëve kërkesat specifike për planet mësimore.
9. Studentët duhet të rishikojnë me kujdes planet e tyre me mësimdhënësin e tyre mentor para se ta mbajnë mësimin. Rekomandohet që studentët mësimdhënës t'ia shpjegojnë planin e tyre mësimdhënësit mentor, të paktën një ditë para se të mbajnë mësim. Kjo siguron kohë që të bëhen ndryshime, nëse mësimdhënësi mentor ka sugjerime me të cilat ora e mbajtur mund të jetë më e suksesshme.
10. Kërkoheq që studentët të mbajnë shënime të organizuara mirë të mësimdhënies së tyre praktike. Shënimet do të përfshijnë:
 - **Portofolion e studentit mësimdhënës:** Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. tregime të shkruara) të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore. Në portofolio studentit duhet të ketë edhe *3-5 reflektime të mësuesit mentor* për orët, të cilat studentit i ka mbajtur në mënyrë të pavarur. Gjithashtu studentit duhet të ketë së paku *2 reflektime nga studentë të tjerë*, kolegë të fakultetit. Të gjitha dokumentet nga portofolio dorëzohen tek profesori i lëndës: Praktika pedagogjike, në formë elektronike.
 - **Ditarin e studentit mësimdhënës.** Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv, duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar, dhe synimet e tij/saj për të nxënëit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënëit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studentit ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.
11. Kërkoheq që studentët të kenë portofoliot e tyre të njësive mësimore dhe ditarët e tyre në çdo kohë në klasë.
12. Kërkoheq që studentët të angazhohen në vetëvlerësim që përfshin caktimin e qëllimeve të nxënies dhe të çmuarit, si dhe vlerësimin vazhdues të përparimit në arritjen e atyre qëllimeve.

VI. KODI I MIRËSJELLJES PROFESIONALE PËR STUDENTËT MËSIMDHËNËS

Ky KOD për Mirësjellje Profesionale për Studentët Mësimdhënës kërkon standardet e sjelljes profesionale që pritet nga studenti mësimdhënës.

Në lidhje me nxënësit

- Studenti mësimdhënës i mëson dhe bashkëvepron me nxënësit, në atë mënyrë që të respektojë dinjitetin dhe të drejtat e të gjithë njerëzve pa paragjykime për kombësinë, religjionin, gjininë, karakteristikat fizike, moshën, origjinën, ose vendin nga kanë ardhur.
- Studenti mësimdhënës mund të mos e zbulojë informatën për nxënësin që e ka marrë në besim ose në rrjedhë të detyrave profesionale, vetëm nëse kërkohet nga ligji ose në konsultim me drejtorin e shkollës ose mbikëqyrësit të fakultetit, mund ta bëjë këtë për interes të nxënësit.

Në lidhje me autoritetet e shkollës

- Studenti mësimdhënës respekton autoritetet e shkollës dhe i bën të gjitha bashkëveprimet në mënyrë që të cilësohet si person profesionist.
- Studenti mësimdhënës u përmbahet të gjitha marrëveshjeve të negociuara në emër të studentit nga ana e Fakulteti të Edukimit.
- Studenti mësimdhënës nuk e prish besueshmërinë e studentëve tjerë mësimdhënës, nxënësve ose prindërve ndaj autoriteteve të shkollës.

Në lidhje me studentët tjerë mësimdhënës

- Studenti mësimdhënës bashkëvepron me studentët tjerë mësimdhënës në atë mënyrë që të respektojë dinjitetin dhe të drejtat e të gjithëve pa paragjykime për kombësinë, religjionin, gjininë, karakteristikat fizike, moshën, prejardhjen, ose origjinën e vendit.
- Studenti mësimdhënës nuk e minon besueshmërinë e mësimdhënësve mentorë ose nxënësve të studentët tjerë mësimdhënës.
- Studenti mësimdhënës diskuton punën dhe zotësinë e studentëve tjerë mësimdhënës vetëm nëse ka pajtim të dyanshëm për qëllimin e vlerësimit kolegjial dhe të nxënies së përbashkët.

Në lidhje me Fakultetin e Edukimit

- Studenti mësimdhënës respekton autoritetin e Fakultetit të Edukimit si edhe mësimdhënësit apo bashkëpunëtorët e fakultetit, me të cilët studenti mësimdhënës bashkëvepron.

- Studenti mësimdhënës e njih përgjegjësinë për të shprehur brengat përmes procedurave të duhura drejt autoriteteve të duhura dhe bën kështu në atë mënyrë që të shprehë dinjitetin dhe nderin e të gjithëve që janë të përfshirë.
- Studenti mësimdhënës nuk flet dhe nuk vepron në emër të fakultetit.

Në lidhje me profesionin

- Studenti mësimdhënës vepron në një mënyrë, e cila e shquan dhe e promovon nderin dhe dinjitetin e profesionit.
- Studenti mësimdhënës nuk angazhohet në aktivitetet që negativisht ndikojnë në cilësinë e detyrave profesionale të studentit mësimdhënës.

V. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE

Komponenti i Mësimit praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit.

Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturave nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat.

Tabela 2. Orari i mbajtjes së praktikës pedagogjike

SEMESTRI 1	SEMESTRI 2
Nuk organizohet Mësim praktik	Praktika pedagogjike I
SEMESTRI 3	SEMESTRI 4
Praktika pedagogjike II	Praktika pedagogjike III

Programi i Praktikës pedagogjike I, II dhe III

Qëllimi parësor i komponentit të Mësimit praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë.

Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimit praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së

studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyra e Mësimit praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimit dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimit praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimit praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimit duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës.

Gjatë Mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- **Portofolion:** Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësuesi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.
- **Ditari e studentit mësues:** Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënësit e ardhshëm.

Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënësit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studentit ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.

Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

Përgatitja e portofolios elektronike

Komponentët e e-portofolios

Portofolioja elektronike është një mjet bashkëkohor, që ka zëvendësuar portofoliot fizike, të cilat janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren edhe sot, por në një masë të vogël. Reduktimi i përdorimit të portofoliove fizike ka ndodhur për shkak të disa mangësive ose vështirësive në përdorimin e tyre për zhvillim profesional nga ana e studentëve dhe mësimitdhënësve. Ato, nuk janë të qasshme për mësimitdhënësin, në momentin kur ai ka kohë të lirë për të analizuar reflektimet apo elementet e tjera të prezantuara nga studenti, në mënyrë që studentit t'i japë komente me qëllim të zhvillimit dhe përparimit të praktikave të aplikuara. Gjithashtu, portofoliot fizike, zënë shumë vend dhe mësimitdhënësit mentorë ose profesorët mbikëqyrës, zakonisht nuk kanë hapësirë për t'i ruajtur ato, por edhe për studentët nuk janë të përshtatshëm, sepse çdo ditë shtohen dokumente, të cilat e bëjnë vështirë të menaxhueshëm portofolion.

Shumica e studentëve dhe mësimitdhënësve bashkëkohorë, sot, përdorin e-portofolio, ose portofolio elektronike, e cila ka disa përparësi:


- Zë dokumente, aq sa ti mund të përgatisësh.
- Mund të organizohet në disa pjesë, ku mund të klasifikohen materialet sipas natyrës që kanë (p.sh. një hapësirë për reflektimet për orët e vëzhguara mësimore, një hapësirë për reflektimet ndaj orëve të mbajtura nga studentët- vetëvlerësim, një hapësirë për instrumentet e përdorura për vlerësim formativ dhe sumativ të nxënësve, një hapësirë me plan personal të zhvillimit të studentit, etj.).
- Nuk zë vend (hapësirë fizike).
- Mund t'i qasesh në çdo vend dhe në çdo moment.
- Mësimitdhënësi mentor mund të ketë qasje në çdo moment, kur ka kohë për t'i dhënë feed- back studentit.
- Profesori mbikëqyrës, gjithashtu mund t'i qaset në çdo vend dhe në çdo moment.
- Studenti mund të bëjë vetëvlerësim.
- Studentët mund të bëjnë vlerësim të njëri-tjetrit.
- Studentët mund ta përdorin atë për t'u prezantuar tek një punëdhënës, si dëshmi të angazhimeve gjatë studimeve.

Si mund të krijoni një e-Portofolio


Ekzistojnë web faqe të ndryshme të cilat ofrojnë qasje falas për krijimin e e-portofoliove si p.sh. <http://www.e-portfolios.net/> ose <https://www.weebly.com/>.

Lehtë e përdorshme është web faqja weebly, e cila rekomandohet të përdoret edhe për studentët e Fakultetit të Edukimit.


Krijimi i saj është i thjeshtë, mjafton të hapet një llogari personale (account) tek faqja e paraqitur si në foton më poshtë, tek opsioni SIGN UP – djathtas lart, vetëm herën e parë kur hapni llogarinë tuaj:



Më pas hapet dritarja e më poshtme ku kërkohen të shënohen: Emri, e-mail adresa dhe një fjalëkalim.



Pasi të keni krijuar llogarinë, ju do të qaseni në të përmes opsionit LOG IN.



Çfarë mund të përmbajë një portofolio elektronike?

Çdo faqe në Weebly, sikur në shembullin më lart, emërtohet nga vetë studenti dhe për studentët e Fakultetit të Edukimit ato duhet të emërtohen në gjuhën shqipe. Secili student ka të drejtë të personalizojë faqen e tij të dosjes elektronike sipas shijes personale. Megjithatë, faqet që rekomandohet të hapen (por nuk janë të domosdoshme), janë:

I. Faqja e parë (FAQJA KRYESORE)

1. Të dhënat personale:

- Emri dhe mbiemri të shoqëruar me foto.
- Vendbanimi.
- Lëmia – profesioni.
- Institucioni ku punohet.
- Të dhënat tjera personale shtesë sipas dëshirës.

2. Kontaktforma:

- Mundësia për të bërë pyetje dhe komente.

II. Faqja e dytë (SHKOLLIMI - PËRGATITJA AKADEMIKE)

1. Shkollimi fillor

- Vendi, koha dhe institucioni

2. Shkollimi i mesëm

- Vendi, koha, institucioni dhe drejtimi.

3. Shkollimi i lartë dhe pasuniversitar

- Vendi, koha, institucioni (universiteti), fakulteti, drejtimi dhe titulli i fituar.

III. Faqja e tretë (PËRGATITJA PROFESIONALE – PËRVOJA E PUNËS)

1. Pozita e punës

- Vendi, institucioni, koha.
- Përshkrim i shkurtë i përgjegjësive të kësaj pozite.

IV. Faqja e katërt (REFLEKTIME NGA ORËT E VËZHGUARA)

1. Orë mësimore e tipit: Njësi e re mësimore.
2. Orë mësimore e tipit: Përsëritje dhe përforsim.
3. Orë mësimore e tipit: Kontrollim i njohurive/ vlerësim.

V. Faqja e pestë (VETËVLERËSIM – REFLEKTIME PËR ORËT E MBAJTURA)

1. Reflektimi 1 (data, shkolla, klasa).
2. Reflektimi 2 (data, shkolla, klasa).

VI. Faqja e gjashtë (MODELE TË PLANIFIKIMIT)

1. Planifikimi i një ore mësimore.
2. Planifikimi javor.
3. Planifikimi dymujor.
4. Planifikimi global.

VII. Faqja e shtatë (INFORMATA TJERA)

1. Foto galeri.
2. Dokumente.
3. Video.
4. Etj.

Më detajisht në lidhje me procesin e krijimit të e-portofolios, studentët do të përkrahen për llogaritë e tyre personale në Weebly gjatë Praktikës pedagogjike I, nga profesori i lëndës.

VI. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE I

Njoftimi me shkollën dhe mësimdhënësin mentor

Studentët njoftohen me lokacionin dhe organizimin e shkollës dhe të klasës së tyre brenda shkollës. Ata takojnë drejtorin e shkollës dhe njoftohen me mësimdhënësin e tyre mentor. Studentët duhet të njoftohen me orarin e shkollës (koha e fillimit, koha e mbarimit, koha e pushimit dhe t'i shënojnë këto në ditar) dhe me rutinat dhe rregullat e klasës.

Zhvillimi i njohurive për mësimdhënien

Gjatë këtij aktiviteti vlerësohet zhvillimi i vazhdueshëm i njohurive të studentëve për fushën kurrikulare (lëndën) dhe aspektet themelore nga psikologjia dhe pedagogjia e përgjithshme. Studentët do të bëjnë shqyrtimin fillestar të njohurive të tyre për lëndën duke u bazuar në kurrikulë, në mënyrë që të vendosin objektiva dhe veprime për zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Objektivat dhe veprimet duhet të regjistrohen në ditar dhe portofolio, të cilat do të shërbejnë si të dhëna për vlerësimin e zhvillimit profesional të studentit në kursin përkatës të Praktikës pedagogjike.

Studentët duhet:

- Të ndajnë rezultatet e shqyrtimit të veprimeve me mentorin në fillim të kursit të Praktikës pedagogjike.
- Të planifikojnë aktivitetet, duke u bazuar në komentet dhe sugjerimet e mentorëve

Vëzhgimi i ambientit fizik dhe shoqëror

Merrni shënime në ditar për vëzhgimin.

Gjatë vëzhgimit të ambientit të klasës, mendoni për ambientin fizik dhe për ambientin shoqëror.

1. Ambienti fizik

- Çfarë mobilie ka në klasë?
- Si janë të rregulluara mobilet? A mund të lëvizin ato?
- A është dhoma e ndriçuar mirë (kur dritat janë të ndezura)? A ka dritare?
- A duket dhoma e rehatshme, e ngushtë apo mjaft e gjerë?
- Përveç mobilieve, çfarë pajisjesh tjera ka në dhomë? (tabelë, shkumës, projektorë, lojëra ...)
- Si është temperatura?
- A janë të vendosura në mure punimet e nxënësve?

2. Ambienti shoqëror

- Çfarë bashkëveprimi mund të shihni ju në mes të nxënësve dhe mësimitdhënësit?
- A është e tërë klasa e inkuadruar në bashkëveprim, a është vetëm një grup i vogël, apo punohet individualisht?
- Çfarë bashkëveprimi mund të shihni midis nxënësve?

Detyrat për ditat

Shkruani një përmbledhje të ditëve tuaja të para dhe pastaj shkruani një gjë që ju e keni mësuar dhe një pyetje që ju e keni për shkollat ose klasat, duke u bazuar në atë që vëzhgohet.

Shembull i shkrimit në ditat nga studenti mësimitdhënësi

Çfarë ditë e mrekullueshme! Drejtori i shkollës më priti aq mirë dhe madje më ofroi edhe kafe. Të gjithë në sallën e arsimitdareve më priten mire. Klasa është përplot me banka dhe karrige. Nxënësit janë të ulur përreth bankave-nga katër veta në secilën bankë. Atyre u pëlqen të bisedojnë me njëri-tjetrin. Nuk e di se si e fiton vëmendjen e tyre mësimitdhënësi, por ata shumë lehtë fillojnë të punojnë. Më duhet ta pyes se si e bën këtë. Pasi mësimitdhënësi e shpjegoi detyrën në matematikë, unë pata rastin që të qarkulloj nëpër klasë dhe t'u ndihmoj nxënësve. Së pari, desha t'ua tregoj përgjigjet, por pastaj e kuptova se duhet vetëm t'i udhëzoj dhe t'u ndihmoj ta gjejnë zgjidhjen vet.

Unë kuptova se nxënësve u pëlqen kur ua mësojë emrat dhe i thërras me emra dhe si e fiton vëmendjen e tyre mësimitdhënësi në fillim të ditës?

Vëzhgimi i organizimit për nxënie

Studentët mësimitdhënësi njihen me faktet se si klasat dhe njësitë mësimore organizohen për të lehtësuar nxënien dhe do të fillojnë të kuptojnë bashkëveprimin në mes të organizimit dhe nxënies në klasat e shkollës së mesme të ulët (dhe shkollës së mesme të lartë). Për shembull, studentët do të vërtetojnë se a është e organizuar nxënia si aktivitet i drejtuar nga mësimitdhënësi apo si aktivitet me nxënësin në qendër?

Detyrat e vëzhgimit

Gjatë vëzhgimit të mënyrës së organizimit të klasave për nxënie shiko të dhënat që vijojnë.

- 1) Çfarë është duke bërë mësimitdhënësi dhe çfarë janë duke bërë nxënësit?

Vepra kështu:

Vërteto dy blloqe të kohës, secili nga 30 minuta - një në mëngjes dhe një pasdite. Shiko dhe merr shënime lidhur me atë se çfarë janë duke bërë nxënësit dhe mësimitdhënësi çdo 10 minuta (shih shembullin e vëzhgimit në tabelën 3.)

Tabela 3. Shembulli i vëzhgimit të organizimit të nxënies

KOHA	MËSIMDHËNËSI	NXËNËSIT
9:00	Qëndron para klasës dhe u flet nxënësve.	Në karriget e tyre, duke e shikuar mësimdhënësin dhe duke dëgjuar.
9:10	Në ballë të klasës duke u lexuar nxënësve nga libri.	Në karriget e tyre duke e dëgjuar mësimdhënësin.
9:20	Duke shkruar në tabelë me shkumës.	Në karriget e tyre duke kopjuar atë që mësimdhënësi është duke shkruar.
9:30	Duke ecur nëpër klasë dhe duke kontrolluar nëse nxënës po shkruajnë atë që mësimdhënësi kishte shkruar në tabelë.	Shumica janë duke kopjuar nga tabela. Disa kanë përfunduar.

2) Vëzhgoni si organizohet një njësi mësimore.

Shëno informata vijuese lidhur me njësinë mësimore:

- Qëllimi i njësisë mësimore (çfarë duhej të mësonin nxënësit?)
- Hyrje (çka tha mësimdhënësi ose çka bëri ai për ta prezantuar njësinë mësimore?)
- Çfarë bëri ose tha mësimdhënësi për të vazhduar (si ua ligjëroi, ose ua mësoi mësimdhënësi nxënësve ato aftësi, ose ato informata që ata duhej t'i mësonin?)
- Çka bëjnë nxënësit për të nxënë (dëgjojnë? përcjellin udhëzimet? shkruajnë? bëjnë ushtrime praktike? lexojnë?)
- Si përfundoi njësia mësimore?

Detyrat për ditat

Shkruani një përmbledhje të ditës dhe përfshini informacione për çka mësuat lidhur me mënyrën se si organizohen klasat për të ndihmuar nxënien dhe si strukturohen njësitë mësimore. Gjithashtu shkruani një pyetje që ju e keni lidhur me organizimin për nxënie në klasa.



Mendoni lidhur me atë se çka bën mësimitdhënësi në klasë dhe planifikoni një aktivitet për hyrjen e orës mësimore.

Fokusi: Vëzhgimi i komunikimit në klasë

Studentët do të njihen me gjuhën që përdoret në klasa dhe do të fillojnë të kuptojnë rëndësinë e të qenit në gjendje për të komunikuar në mënyrë të qartë si mësimitdhënësi. Studentët do të fillojnë të kuptojnë rolin e mësimitdhënësit në stimulimin e zhvillimit të gjuhës dhe natyrën zhvillimore të ngritjes së gjuhës.

Studentët mësimitdhënësi do të vrojtojnë në një orë gjatë Praktikës mësimore. Shënoni gjërat lidhur me atë që keni vëzhguar dhe pyetjet që doni t'i bëni. Diskutoni vëzhgimet dhe pyetjet tuaja me mësimitdhënësin mentor apo me kolegët tuaj.

Detyrat gjatë vëzhgimit të komunikimit në klasë

Merrni shënime në ditarin personal lidhur me vëzhgimet tuaja. Përdorni disa citate në shënime të tuaja. Gjatë vëzhgimit të gjuhës së folur në klasë, shikoni edhe gjërat që vijojnë:

- Si i jep mësimitdhënësi udhëzimet?
- Si bën pyetje mësimitdhënësi?
- Si përgjigjen nxënësit?
- Si bëjnë pyetje nxënësit?
- Si u përgjigjet mësimitdhënësi pyetjeve të nxënësve?
- Si flasin nxënësit me njëri-tjetrin?

Detyra për ditar

Shkruani një përmbledhje të ditës suaj dhe ndonjë gjë që mësuat si dhe shtroni pyetje që ju i keni lidhur me komunikimin në klasë. Përfshini shembuj të gjuhës që keni dëgjuar – pyetjet dhe përgjigjet, diskutimet midis nxënësve dhe midis nxënësve e mësimitdhënësit.

Tabela 4. Shembull i shënimit ne ditar

SHKRIMI PËRSHKRUES	SHKRIMI REFLEKTIV
<p>Zana sot mori shënime lidhur me tre aspektet e komunikimit gojor. Së pari, ajo shkroi fjalë pas fjale mënyrën se si unë i fillova 10 minutat e para të ditës. Së dyti, ajo shënoi pyetjet e mia në citate pasi nxënësit e bënë një aktivitet. Së treti, ajo shkroi në citate ndërveprimet që unë i bëra me nxënësit kur bëja pyetje dhe kur përgjigjesha. Ishte interesante.</p>	<p>Kur unë dhe Zana i ndamë shënime e saj për 10 minutat e para të ditës, Zana vërejti rëndësinë e të qenit të qartë në udhëzime. Ajo e vërejti se si u desh që të riformuloheshin udhëzimet dhe të kontrolloheshin disa nxënës nëse po e kuptonin njësinë para se t'ia nisnin zgjidhjes së detyrave. Së dyti, duke i rishikuar pyetjet e mia, ne vërejtëm se një shumëllojshmëri e të pyeturit të nivelit të lartë do të ishte e dobishme për orën, veçanërisht për të adresuar nevojat e Artës dhe Rinorit.</p> <p>Gjatë ndërveprimit me nxënës unë mëtoj të lavdëroj nxënësit, por jo gjithmonë. Ne të dy u pajtuam se kjo do të ndihmojë nxënësit për të avancuar njohuritë e tyre.</p>



Mendoni lidhur me aftësinë tuaj për të komunikuar me nxënësit dhe jepni udhëzim për zhvillimin e tyre gjuhësor.

Fokusimi në menaxhimin e klasës/sjelljen e nxënësve

Qëllimet:

- Studentët mësimdhënës duhet të fillojnë të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të përshkruajnë rëndësinë e themelimit të përditshmërisë, të bëjnë caktimin për të priturat që kanë prej nxënësve, në mënyrë që të lehtësohet nxënësia.
- Studentët mësimdhënës duhet të vrojtojnë në një klasë tjetër në shkollë. Të marrin shënime lidhur me atë se çka vrojtohet dhe pyetjet që duhen shtruar. Të diskutohen vëzhgimet dhe pyetjet e shtruara me mësimdhënësin tjetër.

Detyrat e vëzhgimit të menaxhimit në klasë

- Merrni shënime në ditarin tuaj.

- Gjatë fokusimit në menaxhimin e klasës fokusohuni në atë që vijon:

1. Rutina

- Cilat çështje praktikohen në fillim të ditës?
- Cilat çështje praktikohen në fund të ditës?
- Cilat çështje tjera janë praktikuar?

2. Skema e kohës

- A është i ngjitur në klasë orari i lëndëve?
- Si e dinë nxënësit se do të ketë ndryshim në atë që bëhet? (zilet, lajmërimet e mësimdhënësit)?

3. Rregullat e klasës

- Cilat janë rregullat për sjellje në klasë?
- A janë të vendosura rregullat në klasë?
- A i bëri mësimdhënësi rregullat? A u caktuan ato bashkë me nxënësit?

Vëzhgimi i sjelljeve të nxënësve

1. Sjelljet e mësimdhënësit

- Si e tërheq mësimdhënësi vëmendjen e nxënësve?
- Si e pranon mësimdhënësi sjelljen e duhur?
- Si sillet mësimdhënësi me sjelljet e papërshtatshme?

2. Sjelljet e nxënësve

- A duket se nxënësit i dinë rregullat dhe atë që pritet nga ta?
- A ju duket se nxënësit bashkëveprojnë me të rriturit dhe me njëri- tjetrin me respekt?

Detyra për ditën

Shkruaj një përmbledhje të veprimtarive të ditës dhe ato që mësuat, si dhe shtroni pyetjet që keni lidhur me menaxhimin në klasë, duke u bazuar në atë që keni vëzhguar.

Tabela 5. Shembull i shënimit në ditar – dita 4

SHKRIMI PËRSHKRUES	SHKRIMI REFLEKTIV
<p>Zana kaloi një ditë të mrekullueshme duke i shikuar teknikat e menaxhimit në klasë. Ajo i ka vëzhguar të priturat e mia që i pata caktuar në fillim të ditës lidhur me punën në grupe.</p> <p>U desh të diskutojmë caktimin e rregullave, sepse unë i pata bërë të gjitha në fillim të vitit. U desh të bëjmë të njëjtën gjë me “tërheqjen e vëmendjes së nxënësve në fillim të orës”.</p> <p>Një nga nxënësit nuk sillej mirë gjatë orës së matematikës, kështu që unë pata rastin të demonstroj një mënyrë për t’u marrë me pasojat.</p>	<p>Zana kishte vërejtur se pasi unë kisha caktuar të priturat për një aktivitet, kam kërkuar nga një nxënës që të përsërisë të priturat për atë aktivitet. Ajo mendoi se do ta përfshijë këtë ide në rutinën e saj të rregullt.</p> <p>Zana më pyeti nëse i kisha përfshirë nxënësit në caktimin e rregullave në fillim të vitit. U desh ta pranoj se nuk e kisha bërë një gjë të tillë, por që do ta bëja shtatorin e ardhshëm.</p> <p>Kur Andi u soll keq, unë e përkujtova, pastaj ia tërhoqa vërejtjen dhe pastaj e largova nga grupi. E largova nga grupi edhe përkundër kundërshtimit të Andit, meqë dëshiroja që Zana të shikonte se duhen marrë hapa të duhur për nxënësit të cilët kërkojnë vëmendjen. Nuk dëshiroja që Zana të shikonte modelin e një mësimdhënësi, i cili vazhdimisht ia tërheq vëmendjen nxënësit që bërtet dhe i vë në dukje se duhet të qëndrojë i qetë dhe të kushtojë vëmendjen mësim.</p>



Mendoni lidhur me faktin se si ndikon te nxënësit organizimi dhe menaxhimi i orëve

Fokusimi në vetvete si mësimdhënës

Qëllimi:

Studentët do të kuptojnë edhe më tej planifikimin dhe organizimin e njësave mësimore/aktiviteteve të caktuara. Ata do të asistojnë, aq sa është e mundur, në planifikimin dhe udhëheqjen e një aktiviteti të shkurtër të nxënies, për një grup të vogël ose për tërë klasën, varësisht si është e përshtatshme. Shembuj të aktiviteteve ku studentët mësimdhënës mund të marrin rol mjaft aktiv janë: diktimi i një liste të fjalëve, demonstrimi i konstruktimit të një shumëkëndëshi me programin geogebra, ose udhëheqja e një eksperimenti në orën e kimisë.

Detyrat e vëzhgimit të vetvetes si mësime dhënë

Kjo detyrë kërkon nga studenti të vëzhgojë veten si mësime dhënë, duke menduar ose duke shkruar si mësime dhënë për përvijën e asistimit ose udhëheqjes së një aktiviteti të nxënies. Vëzhgimi për:

- Çka bëtë për të planifikuar aktivitetin me mësime dhënësin mentor?
- Çka bëtë për të asistuar ose udhëhequr këtë aktivitet?
- A ndiheni të gatshëm për të filluar Mësimin praktik, ku do të merrni pjesë aktive në procesin e të nxënies?
- Duke u bazuar në këtë përvijë, si do ta përshkruanit veten si mësime dhënë?

Detyra për ditare

Shkruaj një përmbledhje për përvijën tuaj gjatë asistimit ose udhëheqjes së aktivitetit të shkurtër të nxënies që ju e kishit planifikuar. Tregoni se çfarë mësuat duke e bërë këtë. Përshkruani reagimet e nxëniesve. Tregoni se a mendoni se ishte e suksesshme. Shkruani pyetjet që i keni lidhur me të qenit mësime dhënë dhe gjithçka që pritet nga ju si mësime dhënë.

Tabela 6. Shembull i shënimit në ditare

SHKRIMI PËRSHKRUES	SHKRIMI REFLEKTIV
<p>Zana dhe unë së bashku mbajtëm një orë të letërsisë sot. Ajo kishte hulumtuar për punën e shkrimtarëve shqiptarë dhe dëshiroi që të udhëheqë njësinë mësimore për Kadarenë dhe veprën e tij. Ajo punoi me nxëniesit me një strategji të quajtur qarqet e letërsisë.</p> <p>Nxëniesit lexuan një fragment dhe pastaj një anëtar i secilit grup do të udhëhiqte diskutimet e grupit për atë fragment.</p> <p>Më pëlqeu aktiviteti dhe kam mësuar shumë nga ai.</p>	<p>Prezantimi i Zanës për letërsinë shqipe e tërhoqi vëmendjen e nxëniesve menjëherë. Paraqitja e fotove me veshje kombëtare i ka fascinuar nxëniesit. Zana pastaj foli për jetën e Kadaresë. Nuk e kisha ditur se Kadare jeton në Paris. Nxëniesit u angazhuan shumë në prezantimin e saj. Strategjia e qarqeve të letërsisë është ajo e cila përfshin të gjithë nxëniesit në aktivitet. Me aktivitete të udhëzuara dhe të strukturuar, nxëniesit patën rastin që të diskutojnë idetë e Kadaresë. Ajo i zgjodhi me kujdes udhëheqësit e diskutimeve, duke u lejuar disa nxëniesve që hezitojnë që edhe ata të jenë kryesues të diskutimeve të grupeve.</p> <p>Ajo më përkujtoi se duhet të përfshij disa shkrimtarë shqiptarë, si p.sh. Lindita Arapi, Natasha Lako ose Ali Podrimja.</p> <p>Edhe unë do të provoj këtë strategji kur të vazhdoj njësinë tjetër lidhur me shkrimtarët shqiptarë.</p>

Mendoni lidhur me...

Mendoni lidhur me zgjedhjen e karrierës suaj. Çka është ajo që ju lë përshtypje nga të qenit mësues? Cila mendoni se do të jetë sfida më e madhe për ju si mësues? Çfarë mund të mësoni gjatë këtyre dy javëve në klasë?

VII. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE II

Gjatë Praktikës pedagogjike II, studentët do të zgjerojnë njohuritë për praktikën mësimore dhe për procesin e vëzhgimit të aktivitetëve në klasë. Procesi i vëzhgimit të aktivitetëve mësimore do të fokusohet në shkollat e mesme të ulëta.

Objektivat e përgjithshme për Praktikën pedagogjike II:

- Aftësimi i studentëve për punë praktike në shkollën e mesme të ulët.
- Vëzhgimi i realizimit të objektivave të kurrikulës bërthamë 2.
- Njohja me metodologjinë e mësimin.
- Organizimi i klasës.
- Planifikimi i punës individuale, në çifte dhe në grupe.
- Motivimi dhe angazhimi i nxënësve.
- Ndërtimi i raporteve bashkëpunuese me të rritur dhe me nxënës.
- Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i vazhdueshëm .
- Aftësimi i studentëve për të mbajtur ditarë dhe për të reflektuar.
- Pjesëmarrja në mësim.
- Aftësimi teknik (krijimi dhe shfrytëzimi i mjeteve mësimore).
- Asistimi i aktivitetëve në mësimdhënie.
- Këshilla dhe udhëzime nxënësve.
- Aftësimi për vëzhgim dhe reflektim të vazhdueshëm.

Aktivitetet

Gjatë Praktikës pedagogjike II, studentët duhet të angazhohen në secilin nga aktivitetet në klasë. Studentët duhet të shënojnë planifikimet dhe reflektimet në ditarët e tyre për aktivitetet në të cilat kanë marrë pjesë.

- Planprogrami mësimor (studentët duhet të vëzhgojnë se si e përdor mësimdhënësi planprogramin për planifikim).
- Ditari i klasës (studentët duhet të njihen me ditarin e klasës).
- Tekstet mësimore dhe materialet tjera mësimore në klasa (studentët duhet të njihen me materialet që përdoren për mësimdhënie dhe të nxënit).
- Aktivitetet jashtëmësimore (studentët duhet të marrin pjesë në aktivitetet jashtë klasës dhe të bëhen të vetëdijsëm për aktivitetet e nxënësve në situata të tilla).

Vërejtje: Të gjitha aktivitetet dhe detyrat e përshkruara për Praktikën pedagogjike I vlejné edhe për Praktikën pedagogjike II.

VIII. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE III

Gjatë Praktikës pedagogjike III, studentët do të zgjerojnë njohuritë për strategjitë e mësimdhënies, proceset e të nxënësve dhe për procesin e vëzhgimit të aktiviteteve në klasë. Procesi i vëzhgimit të aktiviteteve mësimore do të fokusohet në shkollat e mesme të larta.

Objektivat e përgjithshme për Praktikën pedagogjike III:

- Aftësimi i studentëve për punë praktike në shkollën e mesme të lartë.
- Vëzhgimi i realizimit të objektivave të kurrikulës bërthamë 3.
- Njohja me metodologjinë e mësimin.
- Organizimi i klasës.
- Planifikimi i punës individuale, në çifte dhe në grupe.
- Motivimi dhe angazhimi i nxënësve.
- Ndërtimi i raporteve bashkëpunuese me të rritur dhe me nxënës.
- Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i vazhdueshëm.
- Aftësimi i studentëve për të mbajtur ditar dhe për të reflektuar.
- Pjesëmarrja në mësim.
- Aftësimi teknik (krijimi dhe shfrytëzimi i mjeteve mësimore).
- Asistimi i aktiviteteve në mësimdhënie.
- Këshilla dhe udhëzime nxënësve.
- Aftësimi për vëzhgim dhe reflektim të vazhdueshëm.

Aktivitetet

Gjatë Praktikës pedagogjike III, studentët duhet të angazhohen në secilin nga aktivitetet në klasë. Studentët duhet të shënojnë planifikimet dhe reflektimet në ditarët e tyre për aktivitetet në të cilat kanë marrë pjesë.

- Planprogrami mësimor (studentët duhet të vëzhgojnë se si e përdor mësimdhënësi planprogramin për planifikim).
- Ditari i klasës (studentët duhet të njihen me ditarin e klasës).
- Tekstet mësimore dhe materialet tjera mësimore në klasa (studentët duhet të njihen me materialet që përdoren për mësimdhënie dhe të nxënësve).
- Aktivitetet jashtëmësimore (studentët duhet të marrin pjesë në aktivitetet jashtë klasës dhe të bëhen të vetëdijshëm për aktivitetet e nxënësve në situata të tilla).
- **Vërejtje:** Të gjitha aktivitetet dhe detyrat e përshkruara për Praktikën pedagogjike I dhe II vlejné edhe për Praktikën pedagogjike III.

IX. REFLEKTIMI DHE TË SHKRUARIT REFLEKTIV NË DITAR

Çka është reflektimi?

Reflektimi është një **proces i të menduarit aktiv** shpesh i shoqëruar me të shkruarit dhe të folurit. Reflektimi është një mënyrë për të nxjerrë sa më shumë nga një situatë e nxënies. Reflektimi i bën vrojtimet dhe përvojën më të kuptimshme dhe efektive. Hatton & Smith (1995) definojnë reflektimin si “të menduar që ka qëllim veprimin me një vështrim për përmirësim e tij”.

Shkencëtarët e mësimdhënies kanë identifikuar disa lloje të reflektimit. Ato përfshijnë *të shkruarit përshkrues (deskriptiv)*, *reflektimin përshkrues*, *reflektimin dialogues (bashkëbisedimi)* dhe *reflektimin kritik* (Hatton & Smith, 1995). Në vijim paraqiten definicionet e shkurtra të secilit nga këto lloje të reflektimit.

- **Të shkruarit përshkrues** thjesht përshkruan. Nuk është të shkruar reflektiv. Përfshin përshkrimin e ngjarjes(ve) që ka ndodhur, apo përshkruan një vend, apo ambient, mirëpo në këtë të shkruar nuk ka përpjekje për të dhënë arsye apo arsyetime për atë se pse kanë ndodhur gjërat ashtu siç paraqiten.
- **Reflektimi përshkrues.** Përfshin jo vetëm përshkrimin e ngjarjeve, por edhe përpjekje për të dhënë arsye dhe/ose arsyetime për ngjarjet apo veprimet e vrojtuar. Këtu respektohen pikëpamjet dhe mendimet, por shkrimi është në formë të raportit apo përshkrimit.
- **Reflektimi dialogues.** Demonstron një ‘hap mbrapa’ nga ngjarjet/veprimet drejt të menduarit për vetveten, apo të biseduarit me vetveten lidhur me përvojat apo ngjarjet/veprimet. Me fjalë tjera, ai që shkruan reflektim dialogues, po i tregon mendimet e tij/saj lidhur me temën dhe po bën përpjekje që të shpjegojë pse kanë ndodhur ngjarjet apo situatat e përshkruara. Reflektimi i këtillë është analitik dhe mund të përfshijë disa faktorë dhe pikëpamje gjatë përpjekjes për të dhënë argumente dhe kritika. Këtu mund të respektohen jopërputhshmëritë e faktorëve. Ky reflektim përfshinë gjykim dhe marrje parasysh të alternativave të mundshme gjatë përpjekjeve për të shpjeguar.
- **Reflektimi kritik.** Demonstron një vetëdije se ngjarjet dhe veprimet mund të shpjegohen nga pikëpamje të ndryshme dhe se ato ndikohen nga kontekstet e ndryshme historike e socio-politike. Me fjalë tjera, tregon se personi i cili e ka shkruar këtë reflektim kupton se veprimet ose ngjarjet e përshkruara janë bërë komplekse nga shumë faktorë, disa lokalë dhe aktualë dhe disa historikë dhe më të gjerë.

Pse është i rëndësishëm reflektimi për përgatitjen e mësimdhënësve?

Megjithëse ekzistojnë shumë baza dhe ideologji konceptuale mbi mësimdhënien, në përgjithësi qëndron konstatimi se mësimdhënia është edhe art dhe shkencë dhe është komplekse. Mësimdhënia paraqet shumë më tepër se sa të punuarit përmes sjelljeve të përcaktuara. Andaj, të mësosh dikë që të mbajë mësim, është më tepër se sa t’i atribuosh atij një numër shkathtësish të përcaktuara dhe një mënyrë të caktuar të përshtatjes së problemeve dhe zgjidhjeve.

Natyra komplekse dhe vazhdimisht e ndryshueshme e mësimdhënies, sugjeron se mësimdhënësit duhet të mësohen të gjejnë kuptim në vrojtimet dhe përvojat e tyre dhe të mësojnë nga ato. Kjo nxënie e këtillë, do t'u mundësojë atyre që të marrin vendime të drejta lidhur me praktikën e tyre të mësimdhënies. **Të mësuarit për të** reflektuar në vrojtimet dhe përvojat e tyre paraqet themelin për atë nxënie esenciale dhe për marrje të vendimeve.

Andaj, profesorët që përgatisin mësimdhënësit, kanë për detyrë t'u ndihmojnë studentëve mësimdhënësit që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre për t'u angazhuar në reflektim të dobishëm. Duke marrë parasysh katër llojet e reflektimit të përshkruar më lart dhe atë që kërkimet kanë dëshmuar lidhur me zhvillimin e shkathtësive të studentëve mësimdhënësit për të reflektuar, dhe më tutje, duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të programit të ri për përgatitjen e mësimdhënësitve, angazhimi i studentëve mësimdhënësit në reflektimin deskriptiv paraqet një synim të arsyeshëm.

Si mund të angazhohen studentët mësimdhënësit në reflektim?

Dy strategjitë më të përdorura për angazhimin e studentëve mësimdhënësit në reflektim janë, diskutimi dhe shkrimi i ditarëve. Të dy këto strategji mund të jenë të efektshme dhe të dyja mund të bëhen pjesë e strategjive tjera më komplekse, siç janë studimi i rastit, projekti i hulumtimit të veprimit apo 'mikro' mësimdhënia.

Diskutimi dhe shkrimi i ditarëve mund të kombinohet në mënyrë efektive në disa forma. Me fjalë tjera, në disa situata është e udhës që studentët të angazhohen në diskutime në grupe dhe pas këtij diskutimi të pasojë shkrimi individual. Ky kombinim është i përshtatshëm kur një grup studentësh i ka vrotuar ndërveprimet apo demonstrimet e njëjta në një klasë. Pas vrotimit, ata mund të diskutojnë dhe pastaj të fillojnë të shkruajnë individualisht për të sqaruar mendimet e tyre, pasi t'i kenë dëgjuar mendimet e të tjerëve. Në situatat që përfshijnë vetëm një student mësimdhënësit, është më adekuate që studenti së pari të shkruajë dhe pastaj shkrimi i tij të shfrytëzohet si bazë për diskutim në grup. Në situata të këtilla, është praktikë e zakonshme që disa studentë t'i shkëmbejnë shkrimet e tyre gjatë diskutimit, dhe jo që diskutimi i grupit të përqendrohet vetëm në shkrimin e një student.

Udhëzime për diskutim reflektiv

Të gjitha kontributet në diskutim duhen respektuar. Asnjë kontribut në diskutim nuk duhet gjykuar si më i rëndësishëm apo më i saktë se kontributet tjera.

- Nëse diskutimi përfshin shkëmbimin e shkrimeve në ditar, kërkoni që pjesëmarrësi t'i lexojë grupit nga ditari. Pjesa që do të lexohet me zë, duhet të zgjidhet me kujdes dhe duhet të përmbajë informata të cilat duhet t'i kuptojnë dëgjuesit dhe të jetë e gjatë aq sa të tjerët të mos e humbin interesimin.
- Nëse ditarët shkëmbehen në grup, përkujtoni pjesëmarrësit që puna duhet të jetë konfidenciale dhe të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin që disa pjesë të shkrimeve mund të jenë të natyrës personale.
- Udhëhiqni diskutimet me pyetje të hapura, të cilat i bëjnë studentët që t'i analizojnë situatat e paraqitura dhe të mendojnë 'me zë' për faktorët, të cilët ndikojnë në veprimet

dhe reagimet e njerëzve. Pyetjet si këto në vijim mund të ndihmojnë, veçanërisht kur diskutohen ndërveprimet në klasë:

- –Çfarë mendoni pse ka ndodhur kjo?
 - –Si ka mundur të jetë ndryshe po të,...?
 - –Çfarë mendoni pse ka reaguar nxënësi ashtu?
 - –Çfarë mendoni se do ta ketë shtyre nxënësin që të bëjë kështu?
 - –Çfarë do të mendonte nxënësi për...?
 - –Si do ta interpretonin prindërit...?
 - –Si do ta interpretonin kolegët...?
 - –Nga ajo që dini për zhvillimin e nxënësit, çfarë do të parashikonit. . ?
 - –Si jeni ndjerë kur e keni bërë këtë?
 - –Cili ishte reagimi juaj i parë ndaj. . .?
 - –Si krahasohet kjo që ndodhi me...?
- Përmbyllni çdo diskutim reflektiv me fjali, me të cilat i riafirmoni studentët. Ua theksoni atyre se si i shihni ju ata duke i zhvilluar shkathtësitë e tyre për të reflektuar dhe për të mësuar nga përvojat e tyre, dhe u thoni se janë duke u mësuar ‘të mendojnë si mësimdhënës’. Në këtë mënyrë, duke dhënë shembuj të të menduarit profesional të tyre, ju do t’i shtyni ata që të reflektojnë edhe më tepër.

Një porosi për studentët mësimdhënës

Gjurmimet dhe përvoja kanë treguar se mësimdhënësit para shërbimit mundën shumë lehtë të hutohen nga kërkesat e frikshme për reflektim. Është e natyrshme dhe e kuptueshme se brenga e tyre e parë është e lidhur me ndërtimin e shkathtësive të Mësimi praktik dhe me moskuptimin e arsyeve të mundshme prapa ndërveprimeve të klasës. Më tutje, brengë tjetër është perceptimi dhe besimi i tyre se puna e tyre është duke u vlerësuar nga një profesor ose mësimdhënës mentor. Prandaj, është e rëndësishme që të definohet që në fillim se ata mbajnë kontroll për të shkruarit e tyre dhe ajo që thonë nuk do të gjykohet si e vërtetë apo gabim. Studentët mësimdhënës duhet të jenë të sigurt se nuk ka mënyrë të drejtë apo të gabuar të interpretimit të asaj që vrojtojnë ndërkohë që i shikojnë dhe i dëgjojnë nxënësit në klasa.

Përvoja, gjithashtu, ka treguar se është e natyrshme për studentët që janë fillestarë në të shkruarit e ditarit, që shkrimi i tij të jetë më së shumti përshkrues. Shkrimi i tillë duhet të pranohet si pikë fillestare. Të mësuarit se si të reflektohet është një proces që zhvillohet dhe studentët mësimdhënës kanë nevojë për kohë, përvojë, udhëzime dhe inkurajim për të fituar shkathtësi si mendimtarë reflektues, që mësojnë nga të menduarit e tyre dhe ai i të tjerëve.

Udhëzime të përgjithshme për të shkruarit reflektiv

Qartësia në komunikim është esenciale. Shkrimi i ideve shumë shpesh, përdoret për të qartësuar të menduarit e atij që shkruan. Kur shkruani në ditarin tuaj, mbani mend sugjerimet në vijim, që t'ju ndihmojnë për t'ua bërë të qartë të tjerëve atë që mendoni

- Para se të filloni të shkruani, mendoni për audiencën tuaj. Kush është audiencia juaj kryesore? Çfarë nevojash do të ketë ose çfarë dëshiron audiencia juaj të dijë? Në të shkruarit reflektiv, ai që shkruan është audiencia kryesore. Të shkruarit reflektiv shpesh tingëllon si një bisedë në kokën tuaj, të cilën janë të lejuar ta dëgjojnë edhe të tjerët.
- Thuajeni **idenë tuaj kryesore** në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo mund të jetë një fjali apo një pyetje. I shtoni kësaj ideje përshkrime tjera përderisa vazhdoni të shkruarit, duke treguar më shumë për atë që ju mendoni.
- Jepni **shembuj** për të krijuar një pasqyrë të ideve tuaja për lexuesin.
- Kur e paraqitni një **argument ose mendim**, shfaqni pozitën tuaj drejtpërdrejt dhe pastaj përkrahni atë me arsytime.
- **Organizoni** të shkruarit në atë mënyrë që të jetë i qartë për lexuesin tuaj. Edhe pse të shkruarit e ditarit shpesh bëhet në copa të vogla, që mund të lidhen ose të mos lidhen me njëra tjetrën, ndonjëherë do të jetë e rëndësishme që të jenë të strukturuar mirë. Për shembull, nëse jeni duke e ritreguar një incident që ndodhi me nxënësit, përdorni në fillim shprehje të drejtpërdrejta, dhe po ashtu në fund ose fjalët tjera që përshkruajnë sekuencë në mënyrë që të bëhet e mundur për të tjerët të imagjinojnë situatën.
- Zgjidhni fjalë të përshtatshme dhe precize për t'u komunikuar të tjerëve mendimet tuaja sa më saktë që është e mundur. Zgjedhja e fjalëve mund të bëjë ndryshime të mëdha në transmetimin e kuptimit.
- Në të shkruarit reflektiv, përfshini edhe pyetjet që ju bien në mend gjatë kohës kur shkruani ose gjatë kohës së vrojtimit ose mendimit për një situatë të caktuar.
- Baza për të shkruarit më reflektiv janë **idetë tuaja**, por mundet dhe duhet të përfshihen edhe idetë e të tjerëve.
- Tregoni qartë se ajo që ju thoni është **mendimi** juaj. I jepni **arsyet** dhe **faktet** tuaja dhe përse e keni atë mendim të caktuar.
- Të shkruarit reflektiv dallohet nga të shkruarit përshkrues për shkak të përfshirjes së "**të menduarit**". Kjo do të thotë se përfshihet ajo që shkrimtari mendon lidhur me atë që ai/ajo ka parë, ka dëgjuar ose ka përjetuar. Në veçanti, ky tip shkrimi përfshin atë që shkrimtari mendon për domethënien e veprimit që ai/ajo i ka vrojtuar ose fjalët që ai/ajo i ka dëgjuar.
- Shpesh, është e përshtatshme që në të shkruarit reflektiv të përfshihen **materialet referuese**, duke përfshirë **citatat**, për të ndihmuar zgjerimin e ideve. Një shkrim i mirë reflektiv për nxënësit dhe klasat shpesh, përmban **lidhje me teorinë** dhe mund të përfshijë citate nga teoricienët për të forcuar idetë e prezantuara.

Edhe pse të shkruarit e ditarëve mund të mos i respektojë të gjitha rregullat e të shkruarit si duhet (që nuk ndodh me të shkruarit e një eseje formale), ata që shkruajnë duhet ta lekturojnë të shkruarit e tyre për të siguruar se porosia është e qartë dhe në përgjithësi është e mbështetur në konventat e të shkruarit në lidhje me shenjat e pikësimit, drejtshkrimin dhe ndërtimin e fjalisë.

Të shkruarit reflektiv në ditar

Gjurmimet e disa dekadave të fundit fuqimisht përkrahin të shkruarit si mjet të nxënies. Të shkruarit ndihmon qartësimin e të menduarit. Të shkruarit u ndihmon atyre që shkruajnë për të ndërtuar kuptimin dhe t'i japin kuptim botës përreth. Përmes të shkruarit, kuptimi zgjerohet dhe thellohet, informata analizohet, sintetizohet dhe mbahet në mend.

Në përgatitjen e mësimdhënësve, praktika e shkrimit të ditarit është zgjeruar shumë. Më drejt, **të shkruarit reflektiv të ditarit** është njohur si një nga mënyrat më efektive, përmes të cilave studentët mësimdhënës mund të angazhohen në nxënien se si të jepet mësim dhe nxënien për veten e tyre si mësimdhënës. Disa shembuj të shumtë të të shkruarit të ditarit me studentët mësimdhënës përfshijnë:

- Mbatjen e vijmësisë së zhvillimit të aftësive të mësimdhënies.
- Ndhimesën e të treguarit dhe të të shkruarit kreativ të tregimit.
- Shërbimin si një mjet për shënimin e përgjigjeve ndaj të lexuarit, teksteve, punës, filmave, vrojtimeve, intervistave dhe përvojave të tjera të ngjashme.
- Krijimin e një regjistri kronologjik të aktiviteteve.
- Dhënien e kuptimit çështjeve që ndikojnë në jetën e tyre personale.
- Ndhimën për të kuptuar ndërveprimin në klasë.

Fuqia e të shkruarit të ditarit brenda kontekstit të nxënies për të dhënë mësim fillimisht, qëndron në mundësinë e përdorimit për të shënuar reagimet e studentëve mësimdhënës ndaj shkollave, klasave, mësimdhënësve dhe studentëve. Është veçanërisht një mundësi e mirë për studentët që t'i shënojnë reagimet e tyre ndaj disa çështjeve qendrore që e karakterizojnë arsimin, siç janë çështjet e ndikimit politik dhe shoqëror në shkollim, apo pabarazitë financiare dhe në mjete. Të shkruarit e ditarit i ndihmon studentët mësimdhënës që të mendojnë më qartë lidhur me përvojat e tyre në klasë dhe zhvillimin e shkathtësive dhe njohurive profesionale.

Fragmentet në vijim, që janë marrë nga ditarët e studentëve, ilustrjnë faktin se si të shkruarit reflektiv të ditarit ndihmon studentët mësimdhënës që të mendojnë qartë për veten e tyre dhe mësimdhënien.

Përmes të shkruarit, unë kam filluar të mendoj qartë dhe, për më shumë, të zgjeroj reflektimet e mia fillestare për të menduar për temat. Kam filluar të mendoj në letër.

Të shkruarit e ditarit ishte një nga gjërat më me vlerë që unë kam bërë në këtë semestër. Më ka ndihmuar që të gjurmoj besimet dhe filozofitë e mia lidhur me mësimdhënien e ndershme dhe të hapur. Ditari gjithashtu, më ka ofruar një mënyrë të të shënuarit dhe një mënyrë të të reflektuarit mbi zhvillimin tim si mësimdhënës. Duke ditur se besimet e mia

nuk duhet të jenë kongruente me të tjerët për të qenë të “sakta” ishte gjithashtu diçka që u çimentua për mua gjatë këtij semestri.....”

Të shkruarit reflektiv të ditarit është veçanërisht i vlefshëm për studentët mësimdhënës gjatë Mësimimit praktik. Të shkruarit e ditarit u mundëson studentëve mësimdhënës që të bëhen mendimtarë dhe mësimdhënës efektivë. Përmes reflektimeve të shkruara, ata mund të pyesin veten se pse ndodhi një ngjarje ashtu siç ndodhi, dhe pastaj të ndërmarrin hapa për të gjetur zgjidhje për përmirësimin e praktikës së tyre. Derisa ata bëhen reflektivë dhe fillojnë të veprojnë në lidhje me reflektimet e tyre, ata e përmirësojnë aftësinë e tyre për të ofruar përvoja të shkëlqyeshme arsimore për nxënësit brenda shkollave.

Fillimi i të shkruarit reflektiv të ditarit

Kur nga studentët kërkohet që për herë të parë të shkruajnë ditar, nuk është e pazakonshme që reagimi i tyre të jetë negativ. Shumë prej studentëve kurrë nuk janë angazhuar në të shkruarit e ditarit, ose në ndonjë lloj tjetër të shkrimit, përpos nëse kanë qenë të drejtuar nga mësimdhënësi dhe rregullat e të shkruarit t’u jenë treguar qartë. Të shkruarit e ditarit prej studentëve mësimdhënës mund të jetë një pikë kthese, kur ata fillojnë ta kuptojnë vlerën e të shkruarit si mjet të nxënies.

Gjatë fillimit të të shkruarit të ditarit, nuk është e pazakonshme për studentët mësimdhënës që thjesht të shkruajnë një raport kronologjik të asaj se çka kanë bërë. Kjo mund të ishte një pikë fillestare. Këta studentë duhet të inkurajohen dhe të përkrahen për t’i shtuar shkrimit të tyre disa komente reflektive. Në fjalë të tjera, ata duhet të shkruajnë atë çfarë mendojnë se veprimet dhe ndërveprimet e tyre paraqesin dhe nënkuptojnë. Ata duhet ta zgjerojnë të menduarit e tyre, përmes të shkruarit të tyre, për të filluar të shohin se çfarë domethënieje kanë veprimet që ata i kanë shënuar dhe si mund të interpretohen ato.

Dallimi midis një të shënuari të thjeshtë të ngjarjeve dhe të shkruarit reflektiv është se, të shkruarit reflektiv fillon të interpretojë ngjarjet. Të shkruarit reflektiv tregon për të menduarit e atij që shkruan dhe mund të çojë atë që shkruan drejt përgjithësimeve të veprimeve dhe ndërveprimeve të ngjashme. Duke i bërë përgjithësimet nëpër situata dhe ngjarje, ai që shkruan kupton mirë. Në mësimdhënie, të nxënit nga përgjithësimet mund të çojë pastaj deri tek ndryshimi në sjellje dhe deri tek një mësimdhënie e përmirësuar. Shembujt në vijim të shënimeve në ditarët e shkollave të mesme të ulëta ilustrojnë dallimin midis shënimit të ngjarjeve dhe të shkruarit reflektiv.

Tabela 7. Shembulli B: Në shkollë të mesme të ulët

SHËNIMET KRONOLOGJIKE	DITARI REFLEKTIV
<p>Hyra në klasë në orën 8:00 dhe shkrova në tabelë ushtrimin e matematikës për klasën e shtatë.</p>	<p>Sot unë u koncentrova në atë së çka bëjnë nxënësit për të mësuar. Gjëja e parë ishte shënimi i detyrave të matematikës dhe tentimi për t'i zgjidhur ato. Ky ushtrim u bë në mënyrë individuale. Pastaj nxënësit dëgjonin mësimdhënësin gjatë demonstrimit në tabelë për konstruktimin e pesëkëndëshit të rregullt. Konstruktimi në fletoret e tyre ishte një aktivitet individual.</p>
<p>Ora e matematikës filloi në 8:30. Të gjithë nxënësit e kopjuan ushtrimin në fletoret e tyre.</p>	<p>Deri në orën 11:00 shumë nxënës ishin jo të rehatshëm dhe filluan të sillen jo mirë. Vërejta se ata po rrinin ulur për më shumë se dy orë! As unë nuk do të mund të qëndroja ulur kaq gjatë. Nuk duhet të presim që nxënësit e moshës 12 vjeçare të rrinë aq gjatë ulur. Është dashur ta planifikoj mëngjesin në mënyrë që të përfshija lloje të ndryshme të aktiviteteve të nxënies; disa do të kryenin aktivitete individuale dhe disa të tjerë do të punojnin në grupe.</p>
<p>Unë i kontrollova detyrat kur ata i përfunduan. Vetëm pesë nxënës i kishin të gjitha pyetjet e sakta.</p>	<p>Pyetja ime është, “sa kohë mund të pritët nga nxënësit e moshës 12 vjeçare të qëndrojnë ulur dhe të dëgjojnë?”</p>
<p>Në orën 10:00 mësimdhënësi im shpjegoi një njësi nga gjeometria. Ajo konstrukttoi në tabelë pesëkëndëshin e rregullt. Nxënësit pastaj konstruktuan në fletoret e tyre. Unë i ndihmova tre nxënësve që ta përfundojnë konstruktimin, pasi ata ishin shumë të ngadalshëm.</p>	

Gjatë shkrimit të ditarit, ata që shkruajnë duhet të bëjnë zgjedhje në mënyrë që përvoja e tyre e të shkruarit të jetë e qëllimshme dhe e kuptimshme. Edhe pse profesorët e studentëve mësimdhënës mund të sigurojnë të priturat e përgjithshme dhe të sigurojnë disa shembuj, studentët mësimdhënës duhet të inkurajohen për të eksperimentuar me të shkruarit e tyre, për të zbuluar forma dhe strategji që janë të suksesshme për ta. Për shembull, studentët duhet të zgjedhin se çfarë forme të ditarit ata dëshirojnë – a do të shkruajnë ata në fletore të vogla ose a do të mbajnë një portofolio me fletë të ndara, apo do të mbajnë dosje të gjeneruara nga kompjuteri. Ata gjithashtu, duhet të zgjedhin se kur shkruajnë dhe sa shkruajnë.

Një shembull i detyrës për shkrim të ditarit mund të ishte si vijon:

- Shkruaj tri shënime në ditar për çdo javë, në të cilin do të diskutoni vrojtimet dhe pyetjet tuaja lidhur me mësimdhënien në shkollën e mesme të ulët. Përfshini edhe informatat përshkruese dhe mendimet lidhur me çështjet dhe pyetjet që ju i parashtroni. Secili shënim në ditar duhet të jetë përafërsisht një faqe i gjatë.

Për çfarë temash duhet të shkruajnë studentët mësimdhënës?

Zgjedhja e temave varet nga qëllimi i të shkruarit. Duke mbajtur në mend se të shkruarit do t'i ndihmojë studentët të sqarojnë të menduarit e tyre, disa mësimdhënës preferojnë të caktojnë tema në përputhje me temat që studiohen në orë dhe në seminare. Për shembull, kur klasa është duke e studiuar motivimin, nga studentët mund të kërkohet të shkruajnë një shënim në ditar në lidhje me përvojën e tyre e të qenit të motivuar për të nxënë ose e të qenit të pamotivuar dhe të krahasojnë këto dy situata. Një i shkruar i tillë ndihmon studentët të vënë lidhje midis teorisë që ata janë duke e nxënë dhe përvojave që kanë pasur.

Sa i përket të shkruarit të ditarit gjatë Mësimi praktik, studentët kanë nevojë për liri që të shkruajnë për aspektet e mësimdhënies dhe përvojat e tyre, që u kanë ndihmuar atyre më së shumti. Edhe pse disa tema të caktuara mund të jepen pas vrojtimeve në klasë, gjithmonë duhet të ketë raste për studentët që të shtojnë në ditarin e tyre diçka lidhur me temat e interesit personal.

Temat në vazhdim, janë ato për të cilat edukatorët e mësimdhënësve, ndonjëherë, u kërkojnë studentëve mësimdhënës që të shkruajnë në ditarët e tyre:

- Gjëja më e çmueshme për mësimdhënien që ju e keni mësuar deri më tani.
- Besimet që keni pasur për mësimdhënien e që kanë ndryshuar tani.
- Ideja më e vështirë që keni hasur deri më tani.
- Përvojat pozitive dhe negative si studentë (çfarëdo moshe).
- Përvojat pozitive dhe negative të mësimdhënies.
- Brengat për plotësimin e nevojave të të gjithë nxënësve (nevojat e veçanta etj.).
- Nxënia nga ndërveprimi me mësimdhënësit mentorë, mësimdhënësit tjerë, ose bashkëmoshatarët.
- Ditët e para, njësitë e para mësimore, njësia më e mirë mësimore.

Informatat kthyese për ditarët

Përgjithësisht, pranohet nga edukatorët e mësimdhënësve se të shkruarit e ditarit nuk notohet në mënyrë formale. Përderisa të shkruarit e ditarit është shpesh një kërkesë e kursit, veçanërisht e Mësimi praktik, ditarët nuk vlerësohen në mënyrë të njëjtë si do të vlerësoheshin testet ose esetë. Kriteret e vlerësimit, zakonisht, fokusohen në ditari si një mjet për nxënie dhe përfshijnë gjëra të tilla siç janë::

- Përpjekjet e studentëve për të menduar për përvojat,
- Studentët nxjerrin konkluzione nga vrotimet e tyre,
- Studentët bëjnë pyetje me kujdes.

Cilësia e të shkruarit dhe korrektësia e gjërave të tilla siç janë shenjat e pikësimit, nuk janë fokus i të shkruarit të ditarit. **Më i rëndësishëm është të menduarit e studentëve dhe të nxënësve të tyre nga të menduarit.**

Shumë mësimdhënës angazhohen në analizën e vazhdueshme në formë të shkruar në ditarin e studentëve. Dialogu që zhvillohet mund të jetë i dobishëm për të dy palët. Dhënia e analizës në formë të shkruar, i jep mundësi profesorit që të njohë studentët në mënyrë individuale dhe të jetë në rrjedhë me të kuptuarit e studentëve për mësimdhënien, si edhe të kuptojë pyetjet e tyre.

Udhëzime për ditarët e studentëve mësimdhënës

Gjatë të gjitha niveleve të Mësimin praktik, studentët kërkohen të mbajnë një ditar reflektiv. Një pjesë e të shkruarit në ditar do të kërkohet (drejtohet ose urdhërohet) nga profesorët ose mësimdhënësit mentorë, por një pjesë e të shkruarit duhet të drejtohet dhe të kontrollohet nga studenti mësimdhënës.

Studentë, mbani mend se një ditar reflektiv duhet të ketë **lidhje me gjërat që janë të rëndësishme për përvojat e Mësimin praktik dhe për juve** përdorësi i zhvilloni njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet tuaja si mësimdhënës.

Çdo herë që shkruani, provoni të shfaqni të menduarit tuaj e jo të tregoni ngjarjet që keni parë. Disa tema për të cilat mund të shkruani në ditarin tuaj si shtesë e atyre që u janë caktuar nga mbikëqyrësi janë të radhitura më poshtë. Këto janë vetëm sugjerime.

- Vëzhgimi i ndërveprimit ndërmjet nxënësve.
- Vëzhgimi i nxënësit (zhvillimi fizik, kognitiv, emocional, psikologjik).
- Vëzhgimi i raporteve midis prindërve dhe nxënësve.
- Vëzhgimi i mënyrës përmes së cilës mësimdhënësi mentor e paraqet ose e përfundon një aktivitet.
- Organizimi i klasës - si është organizuar dhe pse është organizuar ashtu?
- Vëzhgimi i dallimeve në mes të djemve dhe vajzave derisa angazhohen në aktivitete.
- Disa aspekte të filozofisë së mësimdhënies suaj.
- Pyetjet për të cilat do t'i donit përgjigjet lidhur me një temë të caktuar.
- Ndryshimet që ju i keni vrojtuar në të menduarit tuaj qysh se keni filluar Mësimin praktik.
- Gjërat e mësuara ose pyetjet e ngritura në bisedën me bashkëmoshatarët ose me mësimdhënësit e tjerë.
- Të menduarit për nevojat e nxënësve në një moshë të caktuar ose në një fazë të caktuar të zhvillimit.
- Të menduarit për disa aspekte të të qenit mësimdhënës dhe ballafaqimi i sfidave që paraqet kjo.
- Të menduarit për ndryshimet në shkollim nga koha kur ju keni qenë nxënës deri tash kur jeni bërë mësimdhënës.

Disa detaje:

- Para se të fillojë Mësimi praktik, merrni një ditar me fletë të lidhura që ju do ta përdorni si ditarin tuaj. Mund ta përdorni një ditar që ju mendoni se do t'ju shërbejë si ditar për disa semestra. E shënoni qartë emrin tuaj.
- Sa herë që shkruani në ditar, shënoni datën se kur i keni shkruar ato gjëra.
- Gjatësia e shkrimit në ditar do të ndryshojë nga një gjysmë faqeje deri në një gjatësi prej disa faqesh. Nuk ka gjatësi korrekte ose të gabuar.
- Jini të kujdesshëm gjatë shkrimit të emrave të vërtetë në ditar. Është më mirë t'u referoheni nxënësve vetëm me emrin e tyre (e jo edhe me mbiemër) dhe të rriturve t'u referoheni si “Znj. T” për shembull. Ju mund të zgjidhni nëse doni t'i jepni personave pseudonime.
- Plotësoni ditarin vazhdimisht. Gjatë Mësimimit praktik, shkruani shpesh në ditarin tuaj, në mënyrë që t'ju ndihmojë që të mbani rrjedhën e të nxënit dhe të pyetjeve tuaja. Mund të shkruani derisa jeni në klasë, gjatë asaj kohe kur nuk keni përgjegjësi për mësimdhënie ose për mbikëqyrjen e nxënësve. Mos lejoni që të gjitha gjërat t'i shkruani në fund të ditës.
- Kur të përfundoni të shkruarit në ditarin tuaj, kthehuni prapa dhe lexoni përsëri atë që keni shkruar atë ditë. Përderisa e lexoni, nënvizoni fjalët kyçe, të cilat do t'ju ndihmojnë të identifikoni temën e shënimit në ditar. Ndonjëherë, mund të vendosni që ta shënoni edhe titullin e atij shënimi. Ndonjëherë, mund të vendosni që të shtoni një fjali përmbledhëse ose një pyetje pasi ta keni rilexuar dhe ri-menduar temën.
- Përgatituni që ta ndani ditarin tuaj me mësimdhënësin tuaj mentor, me kolegët tuaj dhe me profesorët tuaj. Edhe pse ditari juaj nuk do të notohet si një ese, mund të kërkohet nga ju që të demonstroi se jeni duke menduar për përvojat tuaja, se jeni duke përparuar sa i përket mundësisë për të menduar si mësimdhënës dhe se mund të shkruani për të menduarit dhe të nxënit tuaj.

X. MBIKËQYRJA E STUDENTËVE MËSIMDHËNËS

Mbikëqyrja


Mësimi praktik është komponent esencial për të mësuar mësimdhënien dhe mbikëqyrja luan një rol të rëndësishëm (Zahorik, 1988). Gjatë kësaj kohe, studentët mësimdhënës janë të përkrahur nga një mësimdhënës nga fakulteti dhe një mësues nga shkolla ku do të mbahet Mësimi praktik, me ç'rast, që të gjithë përbëjnë një trekëndësh të mbikëqyrjes. Është e vërtetuar se mbikëqyrja efektive ndikon pozitivisht në përgatitjen e studentëve mësimdhënës.

Për këtë arsye, ka nevojë për marrëdhënie pozitive personale dhe profesionale ndërmjet mësuesit mentor dhe studentëve, duke përfshirë komunikimin e hapur dhe të sinqertë. Për një Mësim praktik të suksesshëm, është kusht i domosdoshëm që studentët të kenë një mësues mentor, i cili është komunikues, reflektues e mbështetës dhe ka besime e filozofi të qarta në lidhje me mësimdhënien dhe mbikëqyrjen. Të mësuarit për mësimdhënien është një aktivitet që varet nga ndërveprimet sociale dhe, për këtë arsye, mësuesit mentorë duhet të mbikëqyrin zhvillimin e studentëve mësues, duke qenë përkrahës të zhvillimit të aftësive profesionale dhe praktike të tyre.

Cikli mbikëqyrës

Cikli i mbikëqyrjes, i ngjashëm me atë të paraqitur në ilustrimin e bashkëngjitur, është përgjithësisht i pranuar si bazë për mbikëqyrjen e studentëve mësimdhënës. Ky model përqendrohet në tre komponentë kryesorë: **biseda para vëzhgimit, vëzhgimi dhe biseda pas vëzhgimit**. Derisa mund të ketë dallime në zbatimin e ciklit në secilën situatë, është me rëndësi që struktura bazë të respektohet dhe të përcillet.

(I modifikuar për Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës)



Supozimet në të cilat mbështetet qarku i mbikëqyrjes sipas ilustrimit:

- Mbikëqyrësit, mësimitdhënësit mentorë dhe studentët mësimitdhënës janë të gjithë nxënës dhe mund të mësojnë nga njëri - tjetri.
- Mbikëqyrësit dhe mësimitdhënësit mentorë janë mësimitdhënës me shumë njohuri dhe përvojë, të cilët janë të gatshëm që përvojën dhe ekspertizën e tyre ta ndajnë me studentin mësimitdhënës në atë mënyrë, që ta **respektojnë** dhe ta **udhëzojnë** atë.
- Studentët mësimitdhënës konsiderohen si studentë në mësimitdhënie, ata mësojnë për mësimitdhënien. Mësimi praktik për ta është kohë kur ata hulumtojnë, eksperimentojnë dhe mësojnë nga sukseset dhe dështimet e tyre.
- Mbikëqyrësit dhe mësimitdhënësit mentorë do t'i udhëzojnë studentët në planifikimin e aktiviteteve të nxënies dhe të njësive mësimore, dhe pastaj do t'i lejojnë studentët mësimitdhënës që të marrin përgjegjësi për mbajtjen e një aktiviteti apo një njësie mësimore, pa ndërhyrjen e tyre.
- Vlerësimi dhe evaluimi i studentëve mësimitdhënës do të ndahet. Në të do të kenë rol edhe mbikëqyrësi, edhe mësimitdhënësi mentor edhe studentin mësimitdhënës. Vetëvlerësimi i studentit mësimitdhënës ka rol kritik për zhvillimin profesional të tij.
- Mbikëqyrësit dhe mësimitdhënësit mentorë do t'u ofrojnë studentëve informacion kthyes mbështetës pas secilit vërtetim. Një pjesë e këtij informacioni kthyes do të jetë me shkrim.
- Komunikimi (me gojë dhe me shkrim) ndërmjet mbikëqyrësit, mësimitdhënësit mentor dhe studentit mësimitdhënës do të jetë i hapur, i sqartë, dhe i drejtë.
- Mbikëqyrësit, mësimitdhënësit mentorë dhe studentët mësimitdhënës do t'i kryejnë rolet e tyre sipas aftësisë së tyre më të mirë, duke respektuar kohën e njëri - tjetrit, dhe nivelin e zhvillimit të shkathtësive në procesin e mësimitdhënies dhe të mbikëqyrjes.

Raporti profesional

Për të ndërtuar raporte kolegjale e profesionale nevojitet kohë. Mbikëqyrësit dhe mësimitdhënësit mentorë inkurajohen që të punojnë si ekip për t'i udhëhequr dhe për t'i mbështetur studentët mësimitdhënës. Duke e njohur njëri - tjetrin dhe duke i kuptuar qëndrimet e njëri tjetrit lidhur me mësimitdhënien, ata mund t'u ofrojnë studentëve përvoja të nxënies që janë sfiduese dhe mbështetëse.

Dihet mirë se raportet ndërmjet studentëve, mbikëqyrësve dhe mësimitdhënësve mentorë të tyre, gjithmonë, do të karakterizohen me raporte të fuqishme që ekzistojnë në harmoni, posaçërisht ndërmjet studentit, mbikëqyrësit dhe mësimitdhënësit mentor, por kjo fuqi nuk duhet të jetë e dëmshme. Ajo thjesht duhet të pranohet dhe nuk duhet lejuar që të ndikojë në krijimin e përvojave të nxënies cilësore. Karakteristika kryesore e raportit ndërmjet tri palëve duhet të jetë respekti. Secili nga këta tre duhet t'i respektojë dhe t'i çmojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe përvojat e secilit prej tyre. Edhe pse në mes tyre do të ketë dallime, nuk duhet të ketë kritikizëm, padrejtësi apo gjykime të pabaza.

Mbikëqyrësit, mësimdhënësit mentorë dhe studentët mësimdhënës inkurajohen që të krijojnë mundësi për biseda të lira, për t'u njoftuar me mendimet, qëndrimet dhe përvojat e njëri - tjetrit, në mënyrë që kështu ta ndërtojnë një bazë mbi të cilën do të mund të ndërtojnë raporte produktive dhe begatuese në atmosferë demokratike e joautoritative.

Ajo që vijon është një përshkrim i shkurtër i secilit nga gjashtë komponentët e ciklit të mbikëqyrjes, bashkë me disa udhëzime për angazhim në secilën prej tyre.

Biseda para vëzhgimit

Para se ta mbikëqyrë studentin mësimdhënës, duke mbajtur një njësi apo duke e udhëhequr një aktivitet të nxënies, mbikëqyrësi apo mësimdhënësi mentor duhet të bisedojë me studentin mësimdhënës për të përcaktuar qëllimin e vrojtimit. Qëllimet parësore të konferencës para vrojtimit janë:

- tudenti mësimdhënës duhet t'i sqarojë objektivat e njësisë mësimore apo qëllimet e aktivitetit të nxënies dhe çfarë duhet përvetësuar apo arritur. *Thoni se çfarë dëshironi që të mësojnë nxënësit dhe pse do ta bëni atë që synoni.* S
- tudenti mësimdhënës duhet ta shpjegojë kontekstin e njësisë mësimore apo të aktivitetit. Për shembull, të shpjegojë se çfarë aktivitetesh i kanë paraprirë kësaj njësie mësimore. *Ndihmoni mbikëqyrësin që të kuptojë situatën në të cilën ju jeni duke punuar. I thoni mbikëqyrësit se çfarë kanë mësuar nxënësit deri tani, apo në çfarë aktivitetesh janë angazhuar më parë dhe çfarë rregullash do të përcillni.* S
- tudenti mësimdhënës dhe vrojtuesi duhet të pajtohen për fokusin apo qëllimin e vrojtimit. Kjo do të thotë se, studentin mësimdhënës dhe vrojtuesin vendosin se cili aspekt i mësimdhënies apo i udhëheqjes së një aktiviteti do të jetë në qendër të vëmendjes dhe çfarë të dhënash do të shënohen. Për shembull, përqendrimi mund të jetë në të pyeturit ose në dhënien e udhëzimeve. *Thoni mbikëqyrësit se në çfarë sjelljesh dëshironi që ai të përqendrohet dhe t'u japë informata.* S

Në vijim janë dhënë pyetjet, të cilat vrojtuesi mund t'ia bëjë studentit gjatë konferencës para vrojtimit. Studenti duhet të jetë i përgatitur që të përgjigjet në këto pyetje dhe t'ia tregojë vrojtuesit planin e njësisë mësimore apo të aktivitetit.

- Cili është synimi juaj për këtë orë (çfarë doni që të mësojnë nxënësit)?
- Cfarë mund të presësh që të ndodhë në këtë orë (çfarë do të bëni ju dhe çfarë do të bëjnë nxënësit)?
- Si ndërlidhet kjo njësi mësimore apo ky aktivitet me njësitë apo aktivitetet e mëparshme?
- Në cilin aspekt të mësimdhënies dëshironi që të përqendroheni?

Vëzhgimi

Vëzhguesi duhet të ulet në klasë në një vend nga ku mund të shohë më së miri klasën, mësimdhënësin dhe ndërveprimin në mes nxënësve. Në të njëjtën kohë, vëzhguesi duhet të përpiqet që të mos pengojë. Kjo shpesh do të thotë se ai/ajo duhet të ulet në fund të klasës ose të vendit ku zhvillohet aktiviteti.

Gjatë orës, vëzhguesi duhet të shënojë sistematikisht * informatat lidhur me një aspekt të veçantë të sjelljes së studentit mësimdhënës (dhe efektin e asaj sjelljeje), për të çka janë marrë vesh në para-konferencë. Informatat e mbledhura duhet të shkruhen si shënime sa më objektive dhe të paanshme mbi atë që është vrojtuar. Për shembull, një vrojtues mund të shënojë: “mësimdhënësi pyet: “si quhej djali i vogël në këtë tregim?”- Vëzhguesi **nuk do të shkruante**, “bëri pyetje të panevojshme, përgjigjen e së cilës e dinin të gjithë nxënësit.”

Vëzhguesi, po ashtu mund të grumbullojë të dhëna edhe për aspektet e mësimdhënies dhe të ndërveprimit mes nxënësve. Në veçanti, vëzhguesi duhet të mbledhë të dhëna për aspekte, të cilat tregojnë përparësitë dhe përparimin e shkathtësive dhe të të kuptuarit të studentit mësimdhënës, si dhe të mbledhë të dhëna për fushat, në të cilat ka nevojë për zhvillimin e shkathtësive.

Në vijim janë dhënë karakteristikat e mësimdhënies efektive, të cilat njihen në përgjithësi. Vëzhguesi dhe studenti mësimdhënës, posaçërisht në klasat e shkollës së mesme të ulët, mund të zgjedhin që ta përqendrojnë vëzhgimin në një apo më shumë nga fushat e dhëna në vijim:

- **johja e përmbajtjes së lëndës.** A tregon studenti mësimdhënës të kuptuarit konceptual të temës? A i përshtatet materiali i njësisë mësimore nivelit të nxënësve? A janë informatat që prezantohen të rëndësishme për qëllimin e njësisë mësimore apo të aktivitetit? N

- **rganizimi dhe qartësia.** A është studenti mësimdhënës i përgatitur mirë? A e fillon ai orën me një pasqyrë të njësisë mësimore dhe a e vazhdon atë në sekuencë logjike? A përfundon ora me një përmbledhje të ideve të rëndësishme? A është i qartë studenti mësimdhënës në prezantimin dhe shpjegimin e përmbajtjes? A përdor studenti mësimdhënës metoda dhe strategji, të cilat i përshtaten qëllimeve të njësisë mësimore dhe nivelit të nxënësve? O

Ndërveprimi ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit. Çfarë llojesh dhe nivelesh të pyetjeve bën studenti mësimdhënës? Si përgjigjet studenti mësimdhënës në pyetjet e nxënësve? A ka diskutim? Nëse po, si nis diskutimi?

Prezantimi dhe entuziazmi. A tregon studenti mësimdhënës entuziazëm për nxënie dhe mësimdhënie? A tregon studenti mësimdhënës entuziazëm dhe interesim nëpërmjet intonacionit të zërit dhe gjesteve jo-verbale?

Sjellja e nxënësit. Si mund të përshkruhet sjellja e nxënësve gjatë orës apo gjatë aktivitetit? A duket që janë të angazhuar dhe marrin pjesë?

Përshtypja e përgjithshme. Çfarë keni vrojtuar lidhur me efikasitetin e studentit mësimdhënës? Çfarë sugjerimesh specifike do të bënit për t'i ndihmuar studentët mësimdhënës që ta ngrisin efikasitetin e tyre?

* Vëzhguesi mund të zgjedhë të përdorë një nga strategjitë e vëzhgimit, të përshkruara në kapitullin **Vëzhgimi**, në këtë doracak.

Analiza

Pas vrojtimit, vrojtuesi duhet t'i rishikojë informatat e mbledhura. Derisa i rishikon të dhënat, vrojtuesi duhet të kërkojë modele të sjelljes, informata të përsëritura dhe shenja të tjera të efikasitetit të mësimdhënies dhe të fushave, ku ka nevojë për zhvillim. Qëllimi parësor i rishikimit të informatave është që ato të ndërlidhen me objektivat e njësisë mësimore dhe që të bëhen përgatitjet për konferencën pas vrojtimit, gjatë së cilës vrojtuesi do t'ia prezantojë informatat studentit mësimdhënës.

Biseda pas vëzhgimit

Menjëherë pas vëzhgimit, studenti mësimdhënës dhe vëzhguesi duhet të takohen për t'i shkëmbyer, analizuar dhe interpretuar informatat e mbledhura. Diskutimi i vëzhgimeve duhet të jetë i sqartë dhe pa gjykime, ku vëzhguesi duhet ta udhëheqë studentin mësimdhënës që ai t'i identifikojë përparësitë e tij dhe fushat, në të cilat nevojiten ndryshime. Konferenca duhet të përfshijë përcaktimin e qëllimeve për zhvillim të mëtejshëm dhe një plan për arritjen e këtyre qëllimeve.

Gjatë konferencës pas vëzhgimit, vëzhguesi mund t'i bëjë studentit mësimdhënës pyetje të këtitilla:

- Në përgjithësi, çfarë mendoni për mbajtjen e orës?
- A mendoni se nxënësit kanë arritur atë që keni synuar dhe planifikuar?
- A ka ndonjë pjesë e orës për të cilën mendoni se ka shkuar veçanërisht mirë dhe që ju ka pëlqyer më së shumti?
- A ka ndonjë pjesë të orës suaj apo aktivitetit tuaj, për të cilën mendoni se mund të përmirësohet? Nëse po, si do ta bënit atë ndryshe herën tjetër?

Shënimet dhe reflektimet

Vëzhguesi duhet t'ia japë studentit një kopje të informatave të mbledhura dhe një përmbledhje me shkrim të bisedës gjatë konferencës. Përmbledhja duhet të jetë e shkurtër, por duhet të përfshijë përparësitë e identifikuar dhe qëllimet e përcaktuara për zhvillim dhe përmirësim. Studenti mësimdhënës duhet inkurajuar që t'i shënojë në ditarin e tij/saj përparësitë, të cilat i ka identifikuar vrojtuesi. Studenti mësimdhënës, po ashtu duhet të shënojë se si do të punojë drejt qëllimeve që i ka përcaktuar për të përmirësuar mësimdhënien. Shënimet e bëra gjatë konferencës pas vrojtimit mund të përdoren si referencë për dokumentimin e zhvillimit dhe të ngritjes së studentit si mësimdhënës.

Studentët mësimdhënës, po ashtu duhet t'i shënojnë reflektimet e tyre në ditar. Shkrimet e tyre në ditar duhet të përfshijnë të menduarit për njësinë mësimore apo aktivitetin e tyre, e jo të jenë vetëm shënime faktike. Shkrimet e tyre në ditar duhet të tregojnë se si e lidhin ata

teorinë e mësuar me ndërveprimet e tyre me nxënës. Ata duhet të theksojnë qartë se si do të vepronin ndryshe herën tjetër, për të qenë më efektivë ose për të përmirësuar në ndonjë mënyrë punën e tyre.

Përgjegjësia për mbikëqyrjen e studentëve mësimdhënës ndahet mes mbikëqyrësve të fakultetit dhe të mësimdhënësve mentorë. Qëllimi primar i mbikëqyrjes është që t'u ofrojë studentëve mësimdhënës udhëzimet dhe drejtimin që atyre u duhet, për të bërë progres të vazhdueshëm në zhvillimin e tyre si mësimdhënës të aftë.

Udhëzime për mbikëqyrje

- Siguroni analizë të shpeshtë me gojë dhe me shkrim. Komentet dhe informatat kthyese lidhur me punën e studentëve duhet të shkruhen nga mësimdhënësi mentor dhe profesori mbikëqyrës nga fakulteti në ditarin, i cili sigurohet nga studenti. Komentet duhet të përfshijnë edhe lëvdata për punën që është bërë mirë edhe sugjerime se ku duhen bërë përmirësime.
- Gjatë diskutimit me studentin, ndihmoni studentin për të parë përparësitë dhe sukseset, edhe atëherë kur ka gabime. Udhëzoni studentin që të mësojë nga gabimet.
- Së bashku me studentin, përcaktoni një fokusim dhe qëllim të caktuar për secilin vëzhgim të orës së plotë të mbajtur.
- Udhëzoni studentin për të analizuar punën në mënyrë që të shohë ngritjen dhe sferat, që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Pra, udhëzoni studentin që të bëjë vetëvlerësim për të parë se çfarë përmirësimesh janë bërë dhe ku ka nevojë ende për përmirësime.
- Përqendroni vëmendjen në rezultatet e nxënies për secilin semestër dhe i jepni përkrahjen që është e nevojshme për arritjet në secilin nivel. Ky është një program i natyrës zhvillimore, i cili kërkon nga studentët që ta zgjerojnë të kuptuarit dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre gradualisht gjatë dy viteve.

Përmbledhje e procesit të mbikëqyrjes

Procesi i mbikëqyrjes përbëhet nga tri faza. Faza e parë është biseda para vëzhgimit. Kjo është një bisedë e shkurtër ndërmjet mësimdhënësit dhe vrojtuesit për të vendosur për qëllimet e vrojtimit, teknikat të cilat do të përdoren dhe për llojin e informatave që do të mblidhen.

Faza e dytë është mbledhja e informatave (apo e të dhënave). Kjo përfshin vrojtimin e mësimdhënies dhe marrjen e shënimeve për atë që është dëgjuar dhe parë. Faza e tretë është konsultimi. Konsultimi paraqet kohën kur mësimdhënësi dhe vrojtuesi i rishikojnë informatat dhe i diskutojnë ato në kuptimin e qëllimit të vrojtimit. Qëllimi i konsultimit është që informatat të bëhen sa më kuptimplota dhe sa më të dobishme për mësimdhënësin.

Mbledhja e të dhënave

Vëzhgimi ndihmon se si të mblidhen të dhëna (informata lidhur me mësimdhënien) që nuk duhet të përmbajnë gjykime dhe vlera. Konkluzionet dhe përgjithësimet, të cilat mund t'i formojë vrojtuesi gjatë një vrojtimi, duhet të mbahen të ndara nga informatat që e

përshkruajnë mësimdhënien ashtu siç ishte vrojtuar. Sidoqoftë, informata që e kishte çuar vrojtuesin që të bëjë konkluzione mund të ndahet me mësimdhënësin.

Video incizimi shpesh përdoret për të mbledhur të dhëna lidhur me mësimdhënien. Të shikuarit e vetvetes në video incizim mund t'ju ofrojë një mënyrë unike të “shikimit të vetvetes në pasqyrë” derisa mbani mësim. Nëpërmjet shikimit të video incizimit dhe diskutimit me kolegët, mësimdhënësit mund të zbulojnë mënyrat që ata përdorin, kur u prezantojnë nxënësve dhe ndërveprojnë me ta. Derisa të incizuarit gjatë orës mësimore mund të pengojë në fillim, nxënësit në klasë mund të mësohen me prezencën e kamerës dhe të mësojnë ta injorojnë atë, duke mundësuar në këtë mënyrë mbledhjen e të dhënave të sakta.

Të dhënat që mblidhen në lidhje me mësimdhënien duhet të prezantohen në një formë që mund të kuptohet lehtë dhe mund të përdoret nga mësimdhënësi menjëherë. Ka disa mënyra për të mbledhur të dhënat. Ndonjëherë mund të jetë efektive që të kombinohen teknikat për mbledhjen e të dhënave. Sidoqoftë, studentët dhe mbikëqyrësit porositin që gjatë mbledhjes së të dhënave për vrojtimit, që është një punë e vështirë, t'i kushtohet një rëndësi e madhe të qenit të saktë. Në fillim, është më mirë që të punohet me një teknikë në një kohë dhe të punohet në periudha të shkurtra kohore. Pesë teknika, të cilat janë të përshtatshme për t'u përdorur në klasa me studentët mësimdhënës janë të përshkruara më poshtë:

Teknikat e vëzhgimit

Vëzhguesit në klasë, rregullisht përdorin teknika të shumëllojshme. Asnjë teknikë nuk është më e mirë se tjetra. Ajo që është me rëndësi, është që teknika e cila përdoret t'i përshtatet qëllimit të vrojtimit. Kjo do të thotë që vrojtuesi duhet të dijë qëllimin e vrojtimit dhe pastaj të zgjedhë teknikën më të përshtatshme për arritjen e atij qëllimi. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë shembuj të tri teknikave dhe qëllimet, për të cilat ato janë më të përshtatshme.

Tabela 8. Teknikat e vëzhgimit

TEKNIKA	SI TË BËHET	QËLLIMI - KUR TË PËRDORET	KOMENTET
VROJTUESI SI VIDEO KAMERË	<p>Vrojtuksi merr shënime lidhur me atë se çfarë shihet dhe dëgjohe, duke provuar që t'i kapë të gjitha gjërat që ndodhin në klasë.</p> <p>Vrojtuksi, shpesh e shënon edhe kohën e secilës ngjarje si dhe kush ka qenë i përfshirë në të. Kjo mund të bëhet gjithashtu, duke e përdorur videokasetën.</p>	<p>Të përdoret kjo kur vrojtuksi dëshiron që t'i japë mësimdhënësit një 'pasqyrë të madhe' të asaj se çfarë është duke ndodhur në klasë.</p>	<p>Është e pamundur që të vërehen në hollësi të gjitha ato që ndodhin. Të dhënat e shënuara mund ta reflektojnë njëanshmërinë e vrotuesit pasi që ai/ajo zgjedh se çfarë të shënojë.</p>
VËMENDJA E PËRQENDR UAR	<p>Vrojtuksi dhe mësimdhënësi, paraprakisht merren vesh se cilat aspekte të mësimdhënies do të vrojtohen. Për shembull, ata mund të pajtohen që të vrojtohet të pyeturit e mësimdhënësit dhe përgjigjet e nxënësve.</p> <p>Vrojtuksi i shënon pyetjet e bëra dhe përgjigjet e nxënësve si citate.</p> <p>Vrojtuksi mund të shënojë informata lidhur me aspekte të tjera të mësimdhënies, por duhet të përqendrohet në aspektet e identifikuar për vëmendje.</p>	<p>Përdorni këtë atëherë kur mësimdhënësi kërkon informata lidhur me një aspekt të veçantë të mësimdhënies. Shpesh, aspekti i zgjedhur për vëmendje është ai në të cilën mësimdhënësi ka vështirësi dhe e pranon nevojën për shkathtësi më të mira.</p>	<p>Kjo strategji mund të ketë shumë vlerë për studentët mësimdhënës, të cilët kanë nevojë të përqendrohen gradualisht në aspekte të mësimdhënies, në të cilat kanë nevojë që t'i zhvillojnë shkathtësitë. Kjo, po ashtu u ndihmon mësimdhënësve, të cilët mund të identifikojnë një fushë të veçantë të mësimdhënies së tyre, të cilën duan ta ndryshojnë.</p>
SJELLJA NË DETYRË	<p>Vrojtuksi në mënyrë sistematike shënon sjelljen e një apo më tepër nxënësve në intervale të rregullta gjatë një njësie mësimore. Sjellja përshkruhet në kategoritë, të cilat janë vendosur si pajtim i mësimdhënësit dhe vrotuesit para se të fillojë vrojtimi.</p> <p>Shembull i kategorive: "Kryerja e detyrave të caktuara" ose "bisedimi me nxënësit tjerë"</p> <p>Vrojtuksi i shënon sjelljet e nxënësve në intervale kohore të rregullta. Për shembull, çdo pesë minuta.</p>	<p>Përdore këtë kur analiza e sjelljes së studentëve problematikë është e nevojshme.</p>	<p>Të dhënat e mbledhura duhen rishikuar me kujdes për të zbuluar modele të sjelljes. Kur këto modele të jenë të njohura, mund të zhvillohen strategjitë për tejkalimin e problemeve</p>

Tabela 9. Teknikat e vëzhgimit

TEKNIKA	SI TË BËHET	QËLLIMI - KUR TË PËRDORET	KOMENTET
RRJEDHAT GOJORE	Vrojtuksi shënon se kush bisedon me kë, duke i përdorur kategoritë. Për shembull, “mësimdhënësi me studentin”, “mësimdhënësi e lavdëron klasën”, “studenti i bën pyetje mësimdhënësit”. Koha e secilës shprehje shënohet gjithashtu. Shembull: 10:10 mësimdhënësi lavdëron studentin mashkull. 10:11 mësimdhënësi pyet studentin mashkull. 10:12 student i përgjigjet.	Të përdoren, kur dëshirohen, të dhënat që kanë të bëjnë me komunikimin në klasë. Kjo do të zbulojë modelet e bashkëveprimit gojor dhe do të tregojë gjëra si ato, se sa flet mësimdhënësi dhe sa flasin nxënësit.	Është më së miri, që vëzhgimi i ndërveprimit gojor të bëhet gjatë periudhave të shkurtëra në disa kohë të ndryshme gjatë ditëve.
PËRMBAJTJA GOJORE	Shembuj për atë se çfarë thuhet shkruhen në mënyrë të njëjtë, si edhe thuhet. Shembull: mësimdhënësi pyet, “çka mendoni ju?” Nxënësi: “unë nuk e di”.	Përdorni këtë kur ka dyshime rreth stilit, apo nivelit të gjuhës, e cila përdoret në klasë. Shembujt tregojnë stilin e komunikimit, fjalorin dhe gramatikën, si dhe nivelin e gjuhës, i cili përdoret nga mësimdhënësi dhe studentit.	Vrojto për një periudhë të shkurtër kohore, disa herë në ditë. Shënimet për gjuhën e përdorur duhet të analizohen me kujdes. Nëpërmjet analizës mund të identifikohen përparësitë dhe fushat, në të cilat nevojiten përmirësime dhe mund të zhvillohen strategjitë për përmirësim.

Udhëzime për vëzhgimin e studentëve mësimdhënës gjatë Mësimit praktik

Qëllimi

Qëllimi kryesor i vëzhgimit të mbikëqyrësit dhe studentit është që të mësojnë për mësimdhënien, problemet dhe sfidat lidhur me mësimdhënien, si dhe zgjidhjet e mundshme për këto probleme. Edhe pse mbikëqyrësit kanë përgjegjësi për vlerësim dhe evaluim të studentëve mësimdhënës, të gjykuarit mbi mësimdhënien nuk paraqet qëllimin kryesor.

Qëllimi kryesor i vëzhgimit në klasë nga studentët mësimdhënës është që t'u ndihmojë atyre për t'u kyçur në kompleksitetin e klasave dhe rolin e mësimdhënësit. Gjatë Mësimit praktik do të sigurohet mjaft kohë për vëzhgim në klasa. Vëzhgimet e caktuara të klasës do t'u ndihmojnë studentëve që të kuptojnë ambientin e klasës, komunikimin, menaxhimin, si dhe organizimin e aktivitetit të nxënies.

Udhëzime të përgjithshme

1. Mbani mend se të gjitha ato që ju i shihni dhe i dëgjoni derisa jeni duke punuar me mësimdhënës dhe nxënës janë **konfidenciale**. Mos shpërndani thashetheme lidhur me atë që ju keni parë ose dëgjuar.
2. Mbani një regjistër të asaj se çfarë shihni. Shënimi i klasës dhe datën në shënimin tuaj.
3. **Përshkruani atë çfarë ju** shihni dhe dëgjoni, por mos e analizoni dhe mos e vlerësoni atë.
4. Fokusohuni në aktivitetet e caktuara në klasë. **Mos provoni të vëzhgoni dhe të shkruani të gjitha aspektet** e klasës në të njëjtën kohë. Nganjëherë ju do të keni detyra specifike lidhur me atë se çfarë do të vëzhgoni dhe herëve tjera do të mund të zgjidhni se çfarë doni të vëzhgoni. Në vijim janë dhënë disa aspekte të klasave dhe të mësimdhënies, të cilat mund t'i zgjidhni për vëzhgim:
 - Si është e organizuar klasa?
 - Si ballafaqohet mësimdhënësi me sjelljet e nxënësve?
 - Si i motivon mësimdhënësi nxënësit që të marrin pjesë?
 - Si e prezanton mësimdhënësi aktivitetin e ri ose njësinë e re mësimore?
 - Si i angazhon mësimdhënësi nxënësit individualisht, duke krijuar mundësi për dallimet individuale?
 - Llojet e pyetjeve të cilat i bën mësimdhënësi,
 - Mënyrat në të cilat mësimdhënësi e kontrollon të kuptuarit e nxënësve,
 - Si e përfundon mësimdhënësi një aktivitet ose një njësi mësimore dhe si kalon në aktivitetet ose njësitë vijuese?
5. Përdorni vizatimet për të treguar atë që është e vështirë për ta përshkruar me fjalë. Për shembull, vizato një imazh për organizimin e klasës.
6. Shëno sjelljet pa fjalë të mësimdhënësve dhe nxënësve. Shembull, - mësimdhënësi u ul për të shikuar lojën e kukullave, të cilën e luanin nxënësit.
7. Përfshini citate të drejtpërdrejta, kur jeni duke vëzhguar komunikimin në klasë. Kjo do t'ju ndihmojë që të regjistroni tonin dhe natyrën e modeleve të komunikimit në klasë. Për

shembull, pasi të lexohet tregimi, mësimitdhënësi u drejtohet nxënësve që të “zgjedhin personazhin e tyre të preferuar në tregim dhe të vizatojnë një pikturë të tij apo saj.”

8. Pas vrojtimet, ndani vrojtimet tuaja me mësimitdhënësin tuaj mentor. Shumë gjëra mund të mësohen nga të vrotuarit e asaj se si të tjerët e bëjnë këtë, por ju mund të vrottoni vetëm atë që thuhet ose bëhet. Ju nuk mund të vrottoni pse thuhet ajo ose pse bëhet ajo. Kërkoni nga mësimitdhënësi juaj mentor që t’ju ndihmojë të kuptoni pse ai apo ajo bëri disa nga gjërat që ju i keni vrotuar.
9. Derisa jeni duke vrotuar, merrni shënime lidhur me pyetjet që ju lindin, të cilat mund t’i bëni më vonë. Mos e ndërpritni mësimitdhënësin tuaj mentor, përderisa ai apo ajo është duke dhënë mësimit.
10. Përgatituni për të ndarë vrojtimet tuaja me studentët tjerë mësimitdhënësis dhe të mësoni nga diskutimet me ata, lidhur me atë se çka ka vrotuar secili.

Informata të rëndësishme për mbikëqyrësit e studentëve mësimitdhënësis

Qëllimi i vrotimit është reagimi (informata analizuuese). Qëllimi i analizave (reagimeve) është përmirësimi. Por shumë shpesh, vrotimi i mësimitdhënësisve (dhe i studentëve mësimitdhënësis) është pjesë e vlerësimit formal (zyrtar) dhe ky mund të shikohet me frikë. Mësimitdhënësit dhe studentët mësimitdhënësis, të cilët vrotohen, si edhe mbikëqyrësit, të cilët e bëjnë vrotimin duhet të mbajnë në mend se qëllimi përfundimtar është përmirësimi. Vrotimi mund të jetë një mjet i shkëlqyeshëm për t’u dhënë informata kthyese mësimitdhënësisve. Në mënyrë të njëjtë, vrotimi i të tjerëve është një mënyrë e shkëlqyeshme që të mësosh për mësimitdhënësin.

Gjurmimet tregojnë se roli më efektiv për një mbikëqyrës ose për vrotuesit tjerë është që të japë informata kthyese, në mënyrë që t’i ndihmojnë mësimitdhënësit për të parë veten e tyre në gjendjen ku ata janë dhe të punojnë me ata, për t’i përmirësuar aftësitë e tyre. Vetëm atëherë, kur mësimitdhënësit (dhe studentët mësimitdhënësis) zbulojnë se çka ata në të vërtetë bëjnë, ata mund të përparojnë drejt arritjes së asaj çfarë dëshirojnë ose duhet të bëhen.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrësve të studentëve mësimitdhënësis duhet të jetë që ata t’i ndihmojnë studentët që të shohin se çfarë janë duke bërë mirë dhe të shohin si t’i ndryshojnë sjelljet, të cilat nuk i kontribuojnë mësimitdhënësis dhe nxënies efektive

XI. VLERËSIMI I STUDENTËVE MËSIMDHËNËS


Proceset e të çmuarit dhe vlerësimit të ngritjes dhe zhvillimit profesional janë komplekse. Ekzistojnë variacione të ndryshme lidhur me atë se si konceptualizohen dhe si zbatohen ato në praktikë. Përderisa duhet të ketë një përputhje në lidhje me atë se si konceptualizohen këto, që do të thotë se sipas cilave teori janë themeluar ato, si edhe praktikrat që përdoren, nuk ka mënyrë të drejtë për të çmuar dhe vlerësuar studentët mësimdhënës. Programet për përgatitjen e mësimdhënësve përdorin një numër të skemave të ndryshme në mënyrë mjaft të suksesshme. Para se të vazhdohet me skemën e përshtatur nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Prishtinës, është e nevojshme të qartësohen termat matja, vlerësimi dhe vetëvlerësimi, ashtu siç janë përdorur në këtë skemë.

Matja i referohet procesit të mbledhjes së informatave ose të të dhënave dhe rregullimi i tyre në atë mënyrë, që ta bëjë të mundur gjykimin ose vlerësimin. Shumë metoda ose procedura mund të përdoren për të mbledhur informatat ose të dhënat. Matja i paraprin vlerësimit. Për studentët mësimdhënës, të dhënat nga matja do të përfshijnë shënimet në ditar të shkruara nga mësimdhënësit mentorë, profesorët dhe studentët mësimdhënës, si edhe burime të tjera të të dhënave.

Vlerësimi i referohet gjyqimeve të gjërave që maten. Informatat ose të dhënat e mbledhura gjatë matjes duhet të sintetizohen dhe të mendohen para se të bëhet gjykimi. Gjykimet tregojnë se si gjykohet puna e studentëve në krahasim me atë se çka pritjet dhe çmohet. Për studentët mësimdhënës, vlerësimi do të përfshijë gjykimet e bëra nga mësimdhënësit e tyre mentorë, profesorët e tyre dhe nga vetë ata. Këto gjyqime do të shënohen në formularët përfundimtarë të vlerësimit, ku radhiten veçoritë që çmohen.

Vetëvlerësimi i referohet gjyqimit të studentëve mësimdhënës lidhur me punën e tij/saj, duke u bazuar në informatat që ai/ajo i ka mbledhur, sintetizuar dhe i ka menduar gjatë një periudhe kohore

Tabela 10. Matja dhe proceset e vlerësimit



A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Studentët mësimdhënës vlerësohen në secilin nivel (semestër) të Mësimin praktik. Vlerësimi në secilin nivel (në secilin semestër) përfshin tre komponentë themelore: matjen, vlerësimin dhe vetëvlerësimin. Në secilin nivel, zhvillimi dhe arritja çmohen dhe vlerësohen në krahasim me rezultatet e nxënësit të shënuara në përshkrimin e programit dhe të përshkruara në formularin e raportit të mesëm dhe raportit përfundimtar.

Parimet mbi të cilat bazohet matja dhe vlerësimi

- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të drejta dhe të paanshme për të gjithë studentët dhe nivelet e Mësimin praktik.
- Matja dhe vlerësimi janë procese bashkëpunuese, duke përfshirë kontributin e mësimdhënësit mentor, të fakultetit dhe studentit mësimdhënës.
- Vetëvlerësimi nga studenti mësimdhënës është një burim i vlefshëm për vlerësimin përmbljedhës. Ndihma për studentët që të mësojnë të vetëvlerësohen, konsiderohet si ndihmë për studentët që të ndërtojnë bazamentin për nxënie permanente dhe sjellje profesionale.
- Matja është e vazhdueshme dhe e planifikuar, që të japë ndihmë për aftësimin e studentëve.
- Matja njeh dhe reflekton natyrën komplekse intelektuale dhe sociale të mësimdhënies dhe nxënies.
- Matja dhe vlerësimi njohin dhe reflektojnë natyrën zhvillimore të programit dhe të nxënies për mësimdhënie.
- Parimet dhe praktikatat e vlerësimit rishikohen vazhdimisht nga fakulteti, dhe nëse është e nevojshme, i adaptohen kushteve që ndryshojnë dhe të kuptuarit më të qartë.

Procedurat dhe kërkesat në lidhje me matjen dhe vlerësimin

- Studentët do të pranojnë vazhdimisht dhe rregullisht informata kthyese nga mësimdhënësit mentorë, si dhe anëtarët mbikëqyrës të fakultetit. Informata kthyese do të jetë konstruktive dhe do të japë rekomandime për përmirësim të vazhdueshëm.
- Studentëve do t'u jepet informata kthyese në formë të shkruar, në lidhje me punën e tyre, në mes të secilit nivel të Mësimin praktik.
- Informata kthyese që jepet pas përfundimit të gjysmës së kohës në Mësimin praktik, do të tregojë përparësitë dhe fushat që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm për të gjithë studentët. Nëse puna e studentëve nuk është e kënaqshme, kjo do të tregohet qartë dhe studentët, si dhe mbikëqyrësit do të bëjnë plane për t'i plotësuar këto kërkesa.
- Informata kthyese që jepet në mes, do t'i prezantohet studentit dhe do t'i jepet rast për diskutim me mësimdhënësit mentorë, si dhe me anëtarët mbikëqyrës të fakultetit atëherë kur është e mundur.
- Vlerësimi përfundimtar do të ofrohet në formë të shkruar dhe do t'i prezantohet studentit në një bisedë (konferencë) trepalëshe: studenti, mësimdhënësi mentor, mësimdhënësi apo bashkëpunëtori i fakultetit.
- Formularët e vlerësimit përfundimtar do të nënshkruhen nga studenti, mësimdhënësi mentor dhe mësimdhënësi apo bashkëpunëtori i fakultetit.

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Bisedimet me studentët mësimdhënës

Mësimdhënësit mentorë dhe mbikëqyrësit e fakultetit duhet të sigurojnë kohë të mjaftueshme për të biseduar me studentët mësimdhënës gjatë periudhës së Mësimimit praktik. Një pjesë e kohës do të kalohet edhe në bisedimet joformale, pjesa tjetër e kohës do t'i kushtohet bisedimeve më formale dhe më të organizuara. Përmbledhja në vijim tregon idenë lidhur me atë se si do të vazhdonin bisedat e organizuara dhe jep shembuj të llojeve të pyetjeve që mund të bëhen.

Tabela 11. Shembull i skicës së bisedës

SKICA E BISEDES

- **Hyrje**
- **Themelimi i një ambienti të rehatshëm**
- **Caktimi i qëllimit të bisedës**
- **Përmbledhja në lidhje me atë se si do të kalojë biseda**
- **Sigurimi i informatave kthyesë përkrahëse:**
- **Bëj pyetje me përfundim të hapur**
- **Bëj pyetje të ngushta**
- **Përdor të dhënat e mbledhura gjatë vrojtimit**
- **Formulo një fjali që përmbledh atë që është diskutuar**
- **Sigurimi i informatave kthyesë korrigjuese:**
- **Bëj një pyetje me përfundim të hapur**
- **Bëj një pyetje që ndihmon fokusimin në një problem ose në një fushë që ka nevojë për zhvillim**
- **Përdorni të dhënat përkrahëse**
- **Zgjidhja e problemeve dhe caktimi i qëllimeve për të ardhmen:**
- **Identifiko strategji alternative për ndryshim ose eksperimentim**
- **Zgjidh strategjinë që do të përdoret dhe bëni planin, i cili duhet të vijohet**
- **Cakto qëllimin që duhet të arrihet javën/ët e ardhshme**
- **Kontrollo nëse është kuptuar:**
- **Kërko nga studentët që të tregojnë se çka është planifikuar dhe çka do të bëhet**

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Informata kthye të përkrahëse dhe korigjuese

(Shembuj të pyetjeve dhe deklarimeve)

Pyetjet me përfundim të hapur

- Cilat janë disa nga ngjarjet që mendoni se shkuan mirë?
- Pse zgjodhët të përdorni strategjitë dhe materialet që i përdorët?
- Nga njësia mësimore siguruan mjaft informata. Çfarë keni bërë për të siguruar që nxënësit po mësonin?
- Njësia mësimore ka pasur shumë pika të forta. Çfarë mendoni se nxënësit mësuuan?
- Çfarë bëtë ju për t'i mbajtur nxënësit të përfshirë në njësinë mësimore?
- Nxënësit dukej se ishin të lumtur gjatë gjithë kohës që ju punonit me ta. Pse mendoni se ishin të lumtur?

Pyetjet dhe deklarimet e ngushta

- Javën e kaluar ju caktuat qëllimin për të bërë pyetje të nivelit më të lartë. Çfarë bëtë sot që ju ndihmoi për të bërë pyetje më të mira?
- Çfarë bëtë që të jeni në rregull me kohë përderisa vazhdonte aktiviteti i juaj?
- Çfarë bëtë për t'u siguruar se i keni përfshirë të gjithë nxënësit në diskutim?
- Qëllimi i juaj ishte që të siguroheni se të gjithë nxënësit i kuptuan udhëzimet para se të fillonte aktiviteti. Si kontrollonit se ata kanë kuptuar?
- Ora (njësia mësimore) ishte e organizuar mirë sot. Çfarë bëtë ju që ju ndihmoi të qëndroni të organizuar gjatë punës me grupe të vogla?
- Dje, kur aktiviteti juaj përfundoi, dhoma ishte në kaos. Çka bëtë sot që të gjitha lojërat janë larguar dhe dhoma është e pastër?

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Vizitat e stafit akademik në shkollë

Gjatë kohës së Mësimit praktik, studentët mësimdhënës vizitohen nga stafi akademik i caktuar nga Fakulteti i Edukimit

Tabela 12. Vizitat e vëzhgimit

VIZITAT E VËZHGIMIT:	
Qëllimi	Fokusimi në progresin e studentit në raport me standardet e mësimdhënies
Shpeshtësia	<ul style="list-style-type: none">- Së paku një vizitë gjatë Praktikës pedagogjike I- Së paku një vizitë gjatë Praktikës pedagogjike II- Së paku një vizitë gjatë Praktikës pedagogjike III
Koha e qëndrimit në shkollë	2 orë
Çfarë përfshihet?	<ul style="list-style-type: none">- Vëzhgimi i studentit- Biseda me mësuesin mentor- Biseda me studentin- Shqyrtimi i ditarit
Vizitat për ngritjen e cilësisë	
Qëllimi	Kjo vizitë fokusohet në punën e përbashkët me stafin e shkollës, për të siguruar cilësi në Mësimin praktik
Shpeshtësia	<ul style="list-style-type: none">- Së paku dy vizita gjatë Praktikës pedagogjike I- Së paku dy vizita gjatë Praktikës pedagogjike II- Së paku dy vizita gjatë Praktikës pedagogjike III
Koha e qëndrimit në shkollë	2 orë
Çfarë përfshihet?	<ul style="list-style-type: none">- Takimi me studentin, mësuesin mentor dhe diskutimi rreth portofolios së studentit (takim i trekëndëshit)- Biseda me studentin - dhënia e informatës kthyesë

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Procedurat e vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Për këtë semestër do të përdoret formulari i vlerësimit (fq. 61) që është në vazhdim. Luteni të vëreni se qëllimet kryesore të herës së parë të Mësimit praktik janë:

- Zhvillimi i qëndrimeve dhe sjelljeve të të qenit mësimehënës
- Vrojtimi dhe të nxënës nga ajo që është vrojtuar
- Asistimi i mësimehënësitor mentor dhe të mësuarit se si të bashkëveprohet në mënyra të përshtatshme.

Lutni t'i përcillni këto procedura:

- Jepni studentëve mësimehënës analizë të vazhdueshme (komente). Kjo duhet të bëhet edhe në mënyrë gojore edhe në mënyrë të shkruar (në ditar):
 - a) Bisedoni me mësimehënësitor mentor çdo ditë dhe shkruani në ditar sa më shpesh që është e mundur.
 - b) U tregoni atyre se çka shihni dhe dëgjoni nga studentët mësimehënës dhe që është bërë mirë gjatë punës me nxënës. Tregojani studentit mësimehënës arsyen pse ajo që ata bëjnë është një gjë e mirë.
 - c) Nëse e shihni ose e dëgjoni studentin mësimehënës duke bërë diçka të papërshtatshme ose diçka që mund të bëhet edhe më mirë, kërkoni nga ai të bisedojë me ju në lidhje me veprimin e atij/asaj, në mënyrë që ju të kuptoni konceptin e tij pas asaj sjellje dhe i jepni sugjerime për ta bërë më mirë atë.
 - d) Shkruani komente të shkurtra në ditar, por qëndroni të qartë lidhur me të nxënës që keni vrojtuar, përmirësimet që studentit mësimehënës mund t'i bëjë dhe sugjerimet tuaja lidhur me mënyrën se si mund të përmirësohet studentit mësimehënës.
- Në fund të javës së parë (të dy javëve bllok) kthejuni formularit të vlerësimit me studentin mësimehënës. Tregoni qartë se cilat janë sferat, që kanë nevojë për zhvillim dhe sferat, në të cilat studentit është mjaft i mirë. Bisedoni me studentin mësimehënës lidhur me këtë.
- Bisedoni me profesorin mbikëqyrës lidhur me atë se si dëshiron ai/ajo të bashkëpunojë me ju për ta bërë vlerësimin përfundimtar. Gjatë ditës së fundit që studentit mësimehënës është me ju, plotësoni formularin **dhe nënshkruajeni atë**. Rishikoni formularin me studentin mësimehënës dhe kërkoni nga ai që ta nënshkruajë atë. Nëse profesori nuk kërkon asgjë tjetër nga ju atëherë ia jepni formularin studentit që ta dorëzojë tek profesori.
- Shënoni shënimin e fundit në ditarin e mbikëqyrësit. Në shënimin e fundit, përfshini atë që keni vrojtuar se është përparësia e studentit mësimehënës. Jepni sugjerime për aftësim të mëtejshëm. Nëse është e mundur, shënoni se si ju ka ndihmuar studentit juve dhe nxënësve gjatë kohës që ai/ajo ka qenë me ju.

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Rregullore për vlerësimin e Mësimin praktik të studentëve

Kushtet e përgjithshme

- Mësimi praktik konsiderohet pjesë përbërëse e planit dhe programit të studimeve të Fakultetit të Edukimit.
- Mësimi praktik realizohet gjatë dy viteve të studimeve / në pajtim me planin dhe programin e studimeve.
- Mësimi praktik i studentëve përfshin kohën në shkollë dhe kohën në fakultet/kampus.
- Të gjithë studentët janë të obliguar ta përfundojnë me sukses komponentin e Mësimin praktik, si parakusht për plotësimin e kërkesave për diplomim.

Standardet e profesionit të mësimdhënies

1. **Përgjegjësia dhe përkushtimi ndaj obligimeve dhe detyrave**
Mësimdhënësi student duhet të jetë i përgjegjshëm në raport me obligimet dhe detyrat gjatë Mësimin praktik, si dhe politikave në fuqi që rregullojnë pritjet ndaj punës së mësimdhënësve, duke demonstruar profesionalizëm, saktësi, ndershmëri dhe përkushtim.
2. **Përkushtimi ndaj nxënësve dhe të nxënësve të tyre**
Mësimdhënësi student duhet të dëshmojë përkushtim ndaj nxënësve dhe procesit të të nxënësve. Këtë e bën duke i trajtuar të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt. Nxënësi duhet inkurajuar që të zhvillohet si personalitet dhe t'i kontribuojë zhvillimit shoqëror, si dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës.
3. **Njohuria e kurrikulës, përmbajtjes lëndore dhe si të japësh mësim**
Njohuria profesionale është baza e praktikës së mësimdhënies. Mësimdhënësi duhet ta njohë kurrikulin, materialin e lëndës, nxënësit dhe praktikën e mësimdhënies. Po ashtu, duhet ta njohë legjislacionin që ka të bëjë me arsimin, metodat e komunikimit dhe mënyrat e mësimdhënies në një mjedis që ndryshon shpejt.
4. **Planifikimi dhe zbatimi i mësimdhënies efektive**
Mësimdhënësi student shfrytëzon njohuritë profesionale për të nxitur të nxënësve përmes planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies efektive. Ai/ajo vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësit, si dhe ndryshon dhe përmirëson praktikën e mësimdhënies përmes reflektimit të vazhdueshëm.
5. **Bashkëpunimi me mentorë, me kolegë, me prindër dhe me komunitetin**
Mësimdhënësi student duhet të krijojë mjedis të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për bashkëpunim me mentorët dhe kolegët. Ai/ajo bashkëpunon me kolegë dhe me profesionistë të

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

tjerë, me prindër dhe me pjesëtarë të komunitetit që t'i avancojë praktikën e tij/saj mësimore dhe që të nxisë të nxënit e nxënësve.

6.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Mësimdhënësi student duhet ta kuptojë ndërlidhjen në mes të zhvillimit të vet profesional dhe vlerave e qëndrimeve pozitive për të nxënit dhe mësimdhënien. Ai/ajo duhet të marrë përgjegjësinë për përmirësim të mësimdhënies, duke reflektuar në mënyrë sistematike për efikasitetin e Mësimin dhe qasjen për mësimdhënie.

Vlerësimi i Mësimin praktik për studentët

- Vlerësimi i studentit për Mësimin praktik bëhet përgjatë tre semestrave (ku është planifikuar praktika) si dhe për secilin student.
- Vlerësimi evidencohet në raportin final (Shih: Raporti final).
- Vlerësimi nënkupton aktivitetet e studentit në shkollë, si dhe në angazhimet tjera në fakultet /kampus.
- Mësimi praktik shprehet me ECTS, në pajtueshmëri me planin e studimeve sipas programeve përkatëse.
- Vlerësimi i Mësimin praktik në të gjitha programet bëhet sipas raportit final me: **kalon** dhe **nuk kalon**.
- Formulari për raportin final u shpërndahet studentëve gjatë praktikës.
- Formulari për raportin final, i nënshkruar nga mësimdhënësi mentor, dorëzohet te koordinatori më së largu një javë pas përfundimit të Mësimin praktik.

Çfarë ndodh nëse studenti nuk i plotëson kriteret e parapara?

Në Mësimin praktik është e domosdoshme vijueshmëria e rregullt.

- Në qoftë se studenti mungon nga Mësimi praktik, qoftë nga shkolla apo angazhimet në fakultet, nëse nuk bashkëpunon me mentorin, profesorin mbikëqyrës, apo në ndonjë mënyrë tjetër nuk tregon interesim, atëherë ai nuk kalon në Mësimi praktik.
- Në raste kur studenti nuk kalon në Mësimin praktik, ka të drejtë ta përsërisë praktikën, por vetëm nëse ka arsye të forta dhe këtë në bazë të kërkesës së tij dhe të dokumenteve relevante.
- Studenti ka të drejtë ta përsërisë praktikën e vitit përkatës vetëm një herë gjatë dy viteve të studimeve.
- Vendimin për mundësinë e vijimit të Mësimin praktik (pas shqyrtimit të kërkesës) e merr këshilli i fakultetit

Vlerësimi i studentëve mësimdhënës

Përgjegjësia për vlerësimin e Mësimin praktik ndahet mes profesorëve të Praktikës pedagogjike të Fakultetit të Edukimit, mësimdhënësve mentorë dhe studentëve mësimdhënës. Kjo do të thotë se

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

vlerësimi përfshin edhe vlerësimin nga të tjerët dhe vetëvlerësimin. Të dy këto vlerësime ndodhin në të njëjtën kohë dhe përfshijnë të çmuarit formativ dhe vlerësimin përmbyllës. Fushat e ngritjes profesionale që do të adresohen në çdo semestër kanë qenë të caktuara në rezultatet e nxënësit për secilin semestër dhe të skicuara në formularët relevantë të vlerësimit.

Procesi i vlerësimit përbëhet nga:

Vlerësimi formativ (gjatë Mësimit praktik)

Qëllimi kryesor i vlerësimit formativ është që të informohen studentët për statusin e tyre në lidhje me arritjen e rezultateve të nxënësit për semestrin. Kjo duhet të tregojë qartë fushat e përparësive dhe të të arriturave, si dhe fushat në të cilat përmirësimet dhe aftësimi janë të nevojshme. Kjo duhet të përfshijë edhe një plan për zhvillimin e mëtejshëm dhe rrugët se si të tejkalohet ndonjë dobësi e vërejtur. Vlerësimi formativ, përveç vlerësimit nga ana e mësuesit mentor dhe mësimeve mbikëqyrës nga fakulteti, përfshin edhe formularë të vetëvlerësimit apo vlerësimit të ndërsjellë midis kolegëve (shih shtojcën).

Vlerësimi përmbyllës (final)

Qëllimi kryesor i vlerësimit përfundimtar, në secilin semestër, duhet të tregojë arritjet e përbushjes së standardeve të profesionit të mësimeve nga studentët dhe të dokumentojë përparësitë e studentëve, si edhe sferat që kanë nevojë për përmirësim. Për më tepër, raporti final duhet të përfshijë qëllimet për nivelin e ardhshëm të Mësimit praktik.

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

Procedurat e vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III


- Formulari i vlerësimit përmblylës (fq. 62) duhet të plotësohet për secilin student për semestrin II dhe III.
- Mësimdhënësit mentorë dhe profesorët e Praktikës pedagogjike të fakultetit duhet të bashkëpunojnë gjatë shkrimit të çdo raporti. Kur bashkëpunimi i drejtpërdrejtë nuk është i mundur, raporti duhet të diskutohet përmes telefonit ose të komunikohet përmes postës elektronike.
- Raportet duhet t'i prezantohen dhe të diskutohen me studentin mësimdhënës. Studenti mësimdhënës duhet të nënshkruajë secilin raport, për të treguar se është lexuar dhe diskutuar.
- Një kopje e secilit formular duhet t'i jepet studentit.
- Kur gjatë vlerësimit formativ vërehet se studenti është në rrezik për të dështuar, ai duhet të lajmërohet me shkrim përmes një letre dhe duhet t'i sigurohet informacion i qartë në lidhje me fushat e dobëta, si dhe duhet të formulohet një plan me studentin për të tejkaluar këto dobësi.
- Vlerësimi final nuk bëhet në formë numerike por me fjalë: "KALON", "NUK KALON"

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

SHTOJCA

- A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I
- B. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III
- C. Formulari i vetëvlerësimit
- D. Kërkesë për prindërit e fëmijëve (leje për incizim, fotografim, punime)
- E. Forma për planifikimin e orës mësimore sipas KKK

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I

 <p>UNIVERSITETI I PRISHTINËS Fakulteti i Edukimit</p>	<p>Vlerësimi i përmblendhës i praktikës së mësimdhënësve lëndor në Fakultetin e Edukimit</p>
--	---

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I

Emri i studentit _____
 Mësimdhënësi mentor _____
 Profesori i lëndës _____
 Emri i shkollës _____

Data _____
 Niveli arsimor _____
 Programi i studimeve _____
 Klasa _____

	STANDARDI	Shkalla e vlerësimit			Shkalla e vlerësimit		
1.	Dallon përgjegjësitë e:						
	1. studentit mësimdhënës,	3	2	1	3	2	1
	2. mësimdhënësit mentor dhe	3	2	1	3	2	1
	3. profesorit mbikëqyrës	3	2	1	3	2	1
2.	Ka kuptuar kodin e mirësjelljes profesionale të studentëve mësimdhënës	3	2	1	3	2	1
3.	Ka ndjekur me rregull të gjitha ditët e Praktikës pedagogjike në shkollën e përcaktuar.	3	2	1	3	2	1
4.	Organizon portofolion në kopje fizike dhe atë elektronike https://www.weebly.com/	3	2	1	3	2	1
5.	Shkruan dhe dokumenton në portofolio: Reflektime mbi orët mësimore –	3	2	1	3	2	1
	1. Fokusimi te komunikimi						
	2. Fokusimi te menaxhimi i klasës	3	2	1	3	2	1
	3. Fokusimi te planifikimi i orës mësimore	3	2	1	3	2	1
	4. Fokusimi te vlerësimi i nxënësve dhe	3	2	1	3	2	1
	5. Fokusimi te metodologjia e mësimdhënies	3	2	1	3	2	1
6.	Merr pjesë aktive në analizën e shkrimeve reflektive	3	2	1	3	2	1

A. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike I


gjatë Praktikës pedagogjike në fakultet		
---	--	--

Vlerësimi i vëzhgimit të aktiviteteve gjatë orës mësimore	Demonstrim shumë i mirë i njohurive dhe shkathtësive/ Komente	Demonstrim i mirë i njohurive dhe shkathtësive/ Komente	Nuk demonstroi njohuri dhe shkathtësi të mjaftueshme/ Komente
Vëzhgimi 1	3	2	1
Vëzhgimi 2	3	2	1

Vlerësimi i përgjithshëm. Shënoni në rubrikën e zbrazët: KALON ose NUK KALON	
Nënshkrimi i studentit :	
Nënshkrimi i mentorit :	

Vërejtje: Studenti kalon provimin nëse ka marrë së paku 28 pikë nga mësimdhënësi mentor dhe 28 pikë nga profesori i lëndës. Vlerësimi bazohet në portofolion e studentit, në rregullsinë e ndjekjes së Praktikës pedagogjike në fakultet dhe në shkollë dhe në vëzhgimet e studentit gjatë Praktikës pedagogjike nga mësimdhënësi mentor e profesori.

B. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III

 <p>UNIVERSITETI I PRISHTINËS Fakulteti i Edukimit</p>	<p>Vlerësimi i praktikës së mësimdhënësve lëndor në Fakultetin e Edukimit duke u referuar në standardet e profesionit të mësimdhënies</p> <p>Standardet e profesionit të mësimdhënies dhe treguesit e performancës</p>
--	--

PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III
--------------------------------	---------------------------------

Emri i studentit _____
 Mësimdhënësi mentor _____
 Profesori i lëndës _____
 Emri i shkollës _____

Data _____
 Niveli arsimor _____
 Programi i studimeve _____
 Klasa _____

TË DHËNA NË SHIFRA: 1 – ASPAK 2 – SHUMË PAK; 3 – MIRË; 4 – SHUMË MIRË, 5 – SHKËLQYESHËM

1. Njohuritë profesionale:					
Mësimdhënësi student demonstroi njohuri të kurrikulës, përmbajtjes së lëndës, njohuri pedagogjike dhe njohuri për nevojat e nxënësve, duke siguruar përvoja relevante të mësimdhënies.					
1.1 Adreson standardet e kurrikulës dhe integron elementet kyçe të përmbajtjes	1	2	3	4	5
1.2 Inkorporon zbatimin e proceseve / niveleve të larta mendore gjatë mësimdhënies	1	2	3	4	5
1.3 Tregon aftësinë për të lidhur përmbajtjen aktuale të njësisë, me përvojat e kaluara dhe mundësitë e zbatimit të të nxënësve në të ardhmen në fushat përkatëse dhe / apo në jetën tonë të përditshme	1	2	3	4	5
1.4 Demonstroi njohuri të sakta, të thelluara dhe aktuale për lëndën	1	2	3	4	5
1.5 Zbaton praktikën më të mirë dhe shkathtësitë pedagogjike relevante në mësimdhënien e lëndës (fushën) bazuar në hulumtimet aktuale	1	2	3	4	5
1.6 Bazoi mësimdhënien në qëllimet që pasqyrojnë pritjet më të larta për të gjithë nxënësit dhe një të kuptuar të qartë të kurrikulës	1	2	3	4	5
1.7 Paraqet të kuptuar të karakteristikave të zhvillimit intelektual, social, emocional dhe fizik të grupmoshës ku mësimdhënësi student kryen praktikën	1	2	3	4	5
KOMENTE:					

B. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III

2. Planifikimi i mësimdhënies					
Mësimdhënësi student planifikon mësimdhënien bazuar në udhëzimet e kurrikulës dhe standardeve shkollore, strategjitë efektive, burimet dhe të dhënat e tjera për të adresuar nevojat e diferencuara të të gjithë nxënësve					
2.1 Analizon dhe përdor të dhënat e të nxënit të nxënësve për të planifikuar	1	2	3	4	5
2.2 Zhvillon plane që janë të qarta, logjike, sekuenciale, dhe të integruara në të gjithë kurrikulën (p.sh., qëllimet afatgjata, planet mësimore dhe programi mësimor)	1	2	3	4	5
2.3 Planifikon mësimdhënien në mënyrë efektive për zotërimin e përmbajtjes dhe është në gjendje që ta përshtatë mësimdhënien na bazë të rrethanave	1	2	3	4	5
2.4 Planifikon mësimdhënien për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve	1	2	3	4	5
2.5 Është në gjendje të ndërlidhë rezultatet e të nxënit apo kompetencat bazuar në kurrikulë me nevojat e të nxënit të nxënësve	1	2	3	4	5
2.6 Zhvillon njësitë dhe demonstroi planifikim të përditshëm. Është në gjendje që ta përshtatë dhe ta modifikojë planifikimin varësisht nga nevojat.	1	2	3	4	5
KOMENTE:					
3. Strategjitë e mësimdhënies					
Mësimdhënësi student promovon të nxënit e nxënësve duke përdorur strategjitë më të reja relevante të mësimdhënies, përkatëse për përmbajtjen e lëndës, për të angazhuar nxënësit në të nxënit aktiv dhe për të lehtësuar nxënësit në përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive kryesore					
3.1 Angazhon nxënësit në të nxënit aktiv dhe mban interes të vazhdueshëm	1	2	3	4	5
3.2 Ndërton mbi njohuritë dhe shkathtësitë ekzistuese të nxënësve	1	2	3	4	5
3.3 Përforon qëllimet e të nxënit në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë orës mësimore	1	2	3	4	5
3.4 Përdor një shumëllojshmëri të strategjive bashkëkohore të mësimdhënies	1	2	3	4	5
3.5 Në mënyrë efektive përdor teknologjinë e duhur për të ndihmuar të nxënit tek nxënësit	1	2	3	4	5
3.6 Komunikon dhe paraqet materialin në mënyrë të qartë dhe vazhdimisht kontrollon të nxënit	1	2	3	4	5
3.7 Zhvillon të menduarit e niveleve më të larta nëpërmes ndërveprimit dhe parashtrimit të situatave problemore në kuadër të aktiviteteve	1	2	3	4	5
3.8 Angazhon nxënësit në të nxënit autentik, duke ofruar shembuj nga jeta e përditshme dhe lidhja ndërdisiplinare	1	2	3	4	5
KOMENTE:					

B. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III

4. Strategjitë e vlerësimit					
Mësimdhënësi student zgjedh një shumëllojshmëri të strategjive diagnostike, formative dhe përmbledhëse të vlerësimit dhe instrumentet që janë të vlefshme dhe të përshtatshme për përmbajtjen dhe nxënësit					
4.1 Harmonizon vlerësimin e të nxënit me kurrikulën	1	2	3	4	5
4.2 Përfshin nxënësit në vendosjen e qëllimeve të të nxënit dhe monitorimin e progresit të tyre	1	2	3	4	5
4.3 Ndryshon dhe modifikon vlerësimet për të përcaktuar nevojat dhe progresin individual të nxënësve	1	2	3	4	5
4.4 Përdor vlerësime formale dhe joformale për qëllime diagnostike, formative dhe sumative	1	2	3	4	5
4.5 Përdor praktika të notimit që zotërojnë të nxënit final në marrëdhënie me rezultatet e të nxënit dhe qëllimet e përmbajtjes	1	2	3	4	5
4.6 Përdor teknika të vlerësimit, të cilat janë të përshtatshme për nivelin e zhvillimit të nxënësve	1	2	3	4	5
KOMENTE:					
5. Mjedisi pozitiv i të nxënit					
Mësimdhënësi student duhet të krijojë mjedis të përshtatshëm, të sigurt dhe të qëndrueshëm, që është i favorshëm për mësimnxënie dhe nxit respekt për të gjithë					
5.1 Krijon pritshmëri të qarta për rregullat e klasës, rutinat dhe procedurat, i zbaton ato vazhdimisht dhe në mënyrë të përshtatshme	1	2	3	4	5
5.2 Modelon kujdes, drejtësi, respekt, dhe entuziazëm për mësimnxënie.	1	2	3	4	5
5.3 Promovon një ambient të besueshëm dhe të punës ekipore brenda klasës	1	2	3	4	5
5.4 Në mënyrë aktive dëgjon dhe i kushton vëmendje nevojave të nxënësve	1	2	3	4	5
5.5 Krijon ngrohtësi tërheqëse dhe mjedis mbështetës në klasë	1	2	3	4	5
5.6 Rregullon materialet dhe burimet në klasë për të lehtësuar aktivitetet individuale dhe grupe	1	2	3	4	5
KOMENTE:					

B. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III

6. Profesionalizmi					
Mësimdhënësi student shfaq angazhim për etikën profesionale dhe misionin e shkollës, merr pjesë në mundësitë për zhvillim profesional për të mbështetur të nxënit e nxënësve, si dhe kontribuon në profesionin e mësimdhënësit					
6.1 Kryen detyrat në përputhje me Kodin e Etikës së mësimdhënësit dhe politikat lokale të shkollës	1	2	3	4	5
6.2 Mban sjellje profesionale (p.sh. në pamje, saktësi në kohë dhe vijueshmëri të rregullt)	1	2	3	4	5
6.3 Respekton dhe ruan konfidencialitetin	1	2	3	4	5
6.4 Vlerëson dhe identifikon fushat e forta dhe të dobëta personale që lidhen me aftësitë profesionale dhe ndikimin e tyre në të nxënit e nxënësve dhe përcakton qëllime për përmirësime	1	2	3	4	5
6.5 Demonstron fleksibilitet në përshtatjen me ndryshimet në shkollë	1	2	3	4	5
KOMENTE:					
7. Komunikimi					
Mësimdhënësi student komunikon në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit ose kujdestarët, personelin e shkollës dhe mësimdhënësin mbikëqyrës, si dhe aktorë të tjerë, në mënyrë që të rrisë të nxënit e nxënësve					
7.1 Përdor teknika verbale dhe joverbale të komunikimit për të nxitur ndërveprime pozitive dhe të promovojë të nxënit në mjedisin e klasës dhe të shkollës.	1	2	3	4	5
7.2 Angazhohet në komunikim të vazhdueshëm dhe ndan qëllimet e mësimdhënies, pritjet dhe progresin e nxënësve me familjarët në kohën e duhur	1	2	3	4	5
7.3 Përdor gjuhë të saktë, fjalor dhe gramatikë korrekte, format e duhura të komunikimit me gojë dhe me shkrim.	1	2	3	4	5
7.4 Shpjegon udhëzimet, konceptet dhe përmbajtjen e njësisë mësimore për nxënësit në mënyrë logjike, sekuenciale dhe adekuate për moshën.	1	2	3	4	5
7.5 Krijon një rrugë të hapur për prindërit dhe nxënësit, duke demonstruar një stil bashkëpunues dhe të arritshëm	1	2	3	4	5
7.6 Dëgjon dhe përgjigjet me vetëdije kulturore dhe ndjeshmëri. Përdor mënyrat e komunikimit që janë të përshtatshme për një situatë të caktuar	1	2	3	4	5
KOMENTE:					
Numri i ditëve që studenti nuk ishte prezent në shkollë					

B. Formulari i vlerësimit për Praktikën pedagogjike II dhe III

Vlerësimi i përgjithshëm. Shënoni në rubrikën e zbrazët: KALON ose NUK KALON	
Nënshkrimi i studentit :	
Nënshkrimi i mentorit :	

D. Formular i vetëvlerësimit. Të plotësohet individualisht nga secili student dhe të shërbejë për vetë studentin

Standardet e profesionit të mësimdhënies	Anët e mija të forta	Anët e mija të nevojshme për t'u zhvilluar
<p>1. Njohuritë profesionale</p>	<p>Shembull: Unë kam arritur, që gjatë orëve mësimore, të siguroj gjithëpërfshirjen e nxënësve, duke i dhënë mundësi secilit të zgjedhë aktivitetin që i përshtatet stilit të të nxënësve. Këtë e ka pohuar edhe mësimdhënësi im mentor (I.M), i cili në raportin e tij të vlerësimit më ka shkruar: “ Niveli i gjithëpërfshirjes dhe mundësisë së nxënësve për të zgjedhur aktivitetin më ka impresionuar”</p> <p>Në përfundim të Praktikës pedagogjike kam bërë një pyetësor me nxënësit, të cilët kanë deklaruar se unë, u kam ofruar atyre metodologji të mësimdhënies shumë atraktive, kam qenë shumë i/e qartë në shpjegime dhe se ata janë të kënaqur me angazhimin tim.</p>	<p>Shembull: Në vlerësimin nga ana mësimdhënësit mentor kam marrë “ dobët” në lidhje me këtë standard. Sipas tij/saj, ka pasur shumë raste kur nxënësit përdornin tepër librat, sepse nuk e kishin të qartë mësimin. Kisha pasur shumë herë mundësi që t’ua bëj më të kapshme përmbajtjen, duke përdorur mjete të teknologjisë, por që nuk e kisha shfrytëzuar.</p> <p>Duke u bazuar në këtë, unë e di, se mund të bëj më tepër, që gjatë orëve mësimore të përdor teknika, të cilat zhvillojnë tek nxënësit të kuptuarit dhe do të zhvillohem në përdorimin e programeve kompjuterike, të cilat mundësojnë konkretizimin dhe e bëjnë mësimdhënien time më atraktive.</p>
<p>2. Planifikimi i mësimdhënies</p>		
<p>3. Strategjitë e mësimdhënies</p>		

D. Formular i vetëvlerësimit. Të plotësohet individualisht nga secili student dhe të shërbejë për vetë studentin

4. Strategjitë e vlerësimit		
5. Mjedisi pozitiv i të nxënit		
6. Profesionalizmi		
7. Komunikimi		

Emri dhe mbiemri: _____ **Data:** _____ **Nënshkrimi:** _____

E. Kërkesë për prindërit e fëmijëve (leje për incizim, fotografim, punime)

Data: _____
Për: Prindërit & kujdestarët
Tema: Leje për incizim, fotografim, aktivitete për vlerësimi të studentëve mësimdhënës
Studenti: _____
Profesori mbikëqyrës: _____

KËRKESË PËR PRINDËR

Të nderuar prindër/ kujdestarë, Unë jam një student/studente e Fakultetit të Edukimit dhe jam e obliguar që të përfundoj Mësimin praktik dhe të kaloj me sukses provimin e Praktikës pedagogjike, si pjesë e programit për mësimdhënës.

Si pjesë e vlerësimit të performancës sime në praktikë, më është kërkuar të incizoj një deri dy orë mësimore aktivitetet e organizuara me fëmijët tuaj.

Fokusi kryesor i këtyre incizimeve do të jem unë dhe puna ime në mësimdhënie. Megjithatë, mund të ndodhë që pjesë e incizimeve të jetë edhe fëmija i juaj, nëse ju më jepni lejen tuaj. Unë, gjithashtu, më duhet të dokumentoj edhe disa detyra / aktivitete, që fëmija juaj i ka punuar, të cilat janë pjesë e vlerësimit tim për Praktikën pedagogjike. Nëse përdoren punimet e fëmijëve, emri i tyre do të largohet, por nuk mund të largohet zëri i fëmijëve gjatë incizimeve filmike.

E fundit, për të ndihmuar Fakultetin e Edukimit për të përparuar programet e tyre të edukimit, incizimet mund të përdoren edhe për mësimdhënie gjatë ligjëratave me studentë.

Këto materiale do të ruhen ne CD dhe do të jenë konfidenciale dhe nuk do të publikohen në webfaqe të hapura apo rrjete sociale. Nëse pajtoheni që fëmija juaj të jetë pjesë e këtyre aktiviteteve, ju lutem të nënshkruani kërkesën time.

Sinqerisht,

Studenti/ja nga Fakultetit të Edukimit, UP _____

Unë _____, prindi/kujdestari i _____, jap lejen për incizimin, fotografimin dhe përdorimin e punimeve për studentët dhe Fakultetin e Edukimit, që t'i përdorin ato gjatë zhvillimit të mësimdhënies.


Nënshkrimi: _____
Data: _____

F. Forma për planifikimin e orës mësimore sipas KKK

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkenca e natyrës	Lënda: Kimi	Shkalla e kurrikulës: 5	Klasa:10
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset fizike Tema/ njësia mësimore: Termodinamika-Lëndët e djegshme fosile			
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën: I. 2, II. 1,4,6, III. 1,2,4, IV. 8			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën 1.4 shpjegon ligjin e ruajtjes së energjisë në proceset natyrore, energjinë e brendshme, ndërrimet e saj, rregullin, kaosin, ciklet dhe lidhshmërinë e nxehtësisë me temperaturën.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fjalët kyçe: lëndë të djegshme, fosile, karburante, energji, dyoksid i karbonit			
Rezultatet e të nxënit të lëndës: <ul style="list-style-type: none">• Vlerëson përdorimin e lëndëve djegëse fosile Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none">• Llogarit sasinë e energjisë, të cilën e lirojnë hidrokarburet gjatë djegies• Trego sasinë e karburanteve, që shpenzon Kosova gjatë një viti• Llogarit sasinë e dyoksidit të karbonit, e cila lirohet nga makinat në Kosovë• Shëno së paku tri mënyra se si mund të ndikojmë në zvogëlimin e shpenzimit të lëndëve të djegshme fosile			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletat e përgatitura nga mësimdhënësi, lapsi			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Matematika, shoqëria dhe mjedisi Çështjet ndërkurrikulare: Mbrojtja e mjedisit, zhvillimi i qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Pjesa hyrëse: Diskutohet me nxënës rreth energjisë që është shpenzuar gjatë ardhjes së nxënësve në shkollë me transport, përfitimin e ushqimeve që kemi konsumuar, rrobave, etj.			
Pjesa kryesore: <i>Nxënësve në dyshe u jepet teksti nga mësimdhënësi. Ata lexojnë në heshtje dhe plotësojnë vendet e zbrazëta.</i> Lëndët e djegshme fosile janë depozita gjeologjike të materialeve organike, të formuara nga mbetjet e bimëve dhe kafshëve, të cilat janë shndërruar në qymyr, naftë dhe gaz natyror, nën shtypje të lartë, pa prani të oksigjenit për miliona vite kohë. Me djegien e këtyre lëndëve përfitohet sasi e konsiderueshme e energjisë. Në shoqërinë tonë moderne energjia është faktori kryesor i të mirave, të cilat i kemi, pra gjithçka që përdorim nga prodhimtaria është përfituar dhe transportuar me energji. Nëse krahasojmë nevojat e njeriut për energji në periudha të ndryshme, shohim dallimin e nevojave mesatare për energji: <ul style="list-style-type: none">- Njeriu primitiv ka shpenzuar 8-9MJ (megaxhul)/ditë- Njeriu i shekullit IX ka shpenzuar 300MJ/ditë- Njeriu sot shpenzon rreth 1000MJ/ditë			

F. Forma për planifikimin e orës mësimore sipas KKK

Energjia, e cila përfitohet nga këto lëndë, është mjaft e madhe në krahasim me burimet e tjera dhe është mjaft e lehtë, pra me djegien e tyre. Më poshtë janë paraqitur reaksionet e djegies për dy hidrokarbure.




Detyrë:

- Vlera energjetike e djegies së propanit është 50MJ/kg. Shpreh sasinë e energjisë në kJ/mol, duke ditur masën molekulare relative të propanit (44).

Llogarit sa mole propan janë në 1kg të tij. Përgjigjja _____

- Nëse shikojmë grafikun e mëposhtëm, mund të shohim se energjia, e cila sot përdoret në botë varet shumë nga lëndët e djegshme fosile.



Mirëpo, siç mund të shihet në diagramin e dytë, sasia e tyre është e limituar, pasi që shpejtësia e shpenzimit të tyre është rreth 100000 herë më e madhe se formimi i tyre. Një makinë mesatarisht brenda një muaji shpenzon rreth 80L karburant. Kosova ka rreth 300000 makina të regjistruara.

Llogarit sasinë e karburanteve që shpenzon Kosova gjatë një viti. Përgjigjja: _____

Gjithashtu, një e metë e madhe e lëndëve gjatë djegies së tyre është përfitimi i sasive të mëdha të dyoksidit të karbonit në atmosferë, i cili është një ndër shkaktarët kryesor të “efektit serrë”. Me djegien e 1kg karburant përfitohet rreth 400g dyoksid karboni. Duke u bazuar në shifrat e mësipërme llogarit sasinë e dyoksidit të karbonit, i cili lirohet brenda vitit në Kosovë nga automjetet (gjatë llogaritjes merr 1Lç1kg).

Përgjigjja _____

Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënësve të orës mësimore:

Në fund kërkohet nga nxënësit se si mund të kontribuojnë në zvogëlimin e shpenzimit të lëndëve të djegshme? Shënoni së paku tri mënyra.

Vlerësimi bëhet në vazhdimësi, duke marrë parasysh përgjigjet e dhëna gjatë diskutimit dhe zgjidhjes dhe arsytimit të llogaritjeve.